




RAPORTI

PËR VITIN 2019
PËR REZULTATET
NGA REALIZIMI I STRATEGJISË
PËR REFORMË NË SEKTORIN
E DREJTËSISË 2017-2022

Shkup, korrik 2020



Projekti
finansohet nga
Bashkimi Evropian





***RAPORT PËR VITIN 2019
PËR REZULTATET NGA REALIZIMI
I STRATEGJISË PË REFORMË
NË SEKTORIN E DREJTËSISË
2017 - 2022***

RAPORT PËR VITIN 2019 PËR REZULTATET NGA REALIZIMI I STRATEGJISË PËR REFORMA NË SEKTORIN E JURISPRUDENCËS 2017 - 2022

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Asociacioni për iniciativa zhvillimore - Zenit Shkup

Redaktore:

Dr. Simonida Kacarska

Autorë:

Aleksandar Nikollov

Iva Conevska

Lektor:

Dejan Vasilevski

Përktheu (në shqip):

Orhan Kadrievski

Disenji dhe shtypi:

Relativ

Korrik 2020, Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.96/.99.047(497.7)"2019"(047)

NIKOLLOV, Aleksandar

Raport për vitin 2019 për rezultatet nga realizimi i strategjisë për reformë në sektorin e drejtësisë 2017 - 2022 / [autorë Aleksandar Nikollov, Iva Conevska; përktheu (në shqip) Orhan Kadrievski]. - Shkup : Instituti për politikë evropiane, 2020. - 63 str. : ilustr. ; 25 cm

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4702-48-1

1. Conevska, Iva [автор]

а) Правосудство -- Стратегија за реформа -- Спроведување -- Македонија
-- 2019 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 52766725

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Partneriteti Justicija – kthimi i besimit të qytetarëve", i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve në Ministrinë e Financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

METODOLOGJIA	7
REZYME	9
1. CILËSIA	10
2. EFIKASITETI	14
3. TRANSPARENCA	16
4. PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE KRIJIMI I POLITIKAVE	18
5. INSTITUCIONET E DREJTËSISË	19
6. SFERA NDËSHKIMORE -JURIDIKE	20
7. SFERA JURIDIKE DHE E KUNDËRVAJTJES	23
8. SFERA CIVILE-JURIDIKE	24
PASQYRAT E TREGUESVE SIPAS QËLLIMEVE DHE SFERAVE STRATEGJIKE	27
1. CILËSIA	28
2. EFIKASITETI	39
3. TRANSPARENCA	44
4. PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE KRIJIMI I POLITIKAVE	47
5. INSTITUCIONET E DREJTËSISË	49
6. SFERA NDËSHKIMORE -JURIDIKE	51
7. SFERA JURIDIKE DHE E KUNDËRVAJTJES	54
8. SFERA CIVILE-JURIDIKE	55
KONSTATIME PËRFUNDIMTARE	57

LISTA E SHKURTESAVE

SEREJ	Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë
AKMIS	Sistem i automatizuar informativ për menaxhim me lëndë gjyqësore
AGJPP	Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
PBV	Prodhimi bruto vendor
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
PP	Prokurorë Publikë
KPP	Këshilli i Prokurorëve Publikë
KGJ	Këshilli Gjyqësor

METODOLOGJIA

Plani veprimi për realizimin e Strategjisë për reforma në drejtësi 2017-2022 (Strategjia) përmban tregues që duhet të përcaktojnë shkallën në të cilën masat e Strategjisë zbatohen me sukses. Sidoqoftë, këta tregues janë kryesisht të orientuar drejt monitorimit të produkteve të aktiviteteve të parashikuara dhe u kushtojnë pak vëmendje rezultateve dhe ndikimit të Strategjisë. Për më tepër, treguesit përqendrohen kryesisht në punën e institucioneve të drejtësisë, pa marrë në konsideratë mjaftueshëm ndikimin që Strategjia ka tek qytetarët.

Ky raport bazohet në planin për monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin të rezultateve të Strategjisë për reformë në sektorin e drejtësisë 2017-2022, e cila përmban tregues të orientuar drejt qytetarëve dhe bashkëveprimin e tyre me gjyqësorin, për qëllimet strategjike, drejtimit, masat dhe aktivitetet e Strategjisë. Me futjen e treguesve për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë, të orientuar drejt qytetarëve, projekti “Partneriteti Justicia: Kthimi i besimit të qytetarëve” synon të promovojë sundimin e së drejtës dhe të nxisë një fokus më të madh në të drejtat e njeriut në institucionet e drejtësisë. Treguesit matin rezultatet përmes prizmit të të drejtave të njeriut dhe efekteve mbi qytetarët, kundrejt funksionimit të përgjithshëm të sektorit.

Ky raport përfshin qëllimet e mëposhtme strategjike të Strategjisë: cilësia, efikasiteti, transparenca, planifikimi strategjik dhe politikëbërja, institucionet e drejtësisë, fusha ndëshkimore-korrigjuese, fusha juridike dhe e kundërvajtjes dhe fusha juridike-civile. Treguesit nuk i përfshijnë qëllimet e mëposhtme strategjike të Strategjisë: pavarësia dhe paanësia,¹ përgjegjësia, qasja në drejtësi (me përjashtim të noterisë, përmbarimit dhe ndërmjetësimit), Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve, fusha administrative-juridike.

¹ Me përjashtim të drejtimit strategjik “Buxheti i pavarur dhe i qëndrueshëm gjyqësor, në përputhje me përcaktimin ligjor të të ardhurave kombëtare bruto”.

Një pjesë e treguesve (indikatorëve) në këtë raport janë në nivelin e qëllimit strategjik ose drejtimit strategjik të Strategjisë, dhe të tjerët janë në nivelin e masës ose aktivitetit në Strategjinë. Gjatë zhvillimit të treguesve, janë marrë parasysh edhe qasjet e mëposhtme të referencës për matjen e rezultateve në drejtësi:

- Lista e rezultateve nga viti 2019 për sektorin e drejtësisë të BE-së (EU Justice Sector Scoreboard 2019) ;
- Treguesit e Kombeve të Bashkuara për sundimin e së drejtës (The United Nations Rule of Law Indicators);
- Evaluimi i sistemeve të jurisprudence të Komisionit Evropian për Efikasitet të drejtësisë të Këshillit të Evropës (CEPEJ Evaluation of judicial systems);
- Metodologjia e statistikës gjyqësore nga viti 2011;
- Matrica e monitorimit të performancave të jurisprudence;
- Metodologjia e monitorimit dhe evaluimit të politikave publike.

Raporti është përgatitur në bazë të:

- anketës me 415 qytetarë që kanë kontest, 41 gjykatës dhe 73 nëpunës gjyqësor nga pesë gjykata themelore,² si dhe 94 avokatë dhe 29 prokurorë publikë,³
- anketës me ndërmjetësues, të cilës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues,
- kërkesave për qasje në informata me karakter publik,
- raporteve të publikuara të institucioneve të sistemit të drejtësisë,
- raporteve të publikuara të organizatave civile.

Në këtë raport të dhënat e mbledhura kanë të bëjnë me vitin 2019, ndërsa në një pjesë të indikatorëve është bërë krahasim edhe me gjendjet në vitin 2018.

Draft-raporti u prezantua në një debat të hapur të mbajtur më 30 korrik 2020. Vërejtjet dhe plotësimet nga diskutimi janë inkorporuar në këtë raport. Gjithashtu, raporti ishte lëndë e konsultimit me Ministrinë e Drejtësisë. Vërejtjet, komentet dhe plotësimet nga Ministria janë inkorporuar në këtë raport.

² Gjykata themelore penale në Shkup, Gjykata themelore civile në Shkup, Gjykata themelore në Manastir, Gjykata themelore në Gostivar dhe Gjykata themelore në Shtip.

³ Anketa u realizua në periudhën dhjetor 2019 – shkurt 2020.




REZYME

1. REZYME PËR QËLLIMIN STRATEGJIK: CILËSIA


Drejtimi strategjik “Barazimi i praktikës gjyqësore”: te tre indikatorë nuk mund të bëhet krahasim me vitin 2018, sepse ka të dhëna vetëm për vitin 2019 të siguruar me anketë:

Perceptimi për kompetencën e gjykatësve, në përputhje me anketën e realizuar me avokatë dhe prokurorë publikë: vlerësimi më i shpeshtë është 4, (në shkallë nga 1 deri 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë).




Anketë me avokatë dhe prokurorë publikë

Perceptimi i kompetencës së prokurorëve në përputhje me anketën e realizuar me gjykatës dhe prokurorë publikë: vlerësimi më i shpeshtë është 4, (përgjigje më e shpeshtë –mesatarisht – në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë).



Anketë me avokatë dhe prokurorë publikë

Perceptimi për zbatimin e standardeve për përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore sipas anketës të realizuar me gjykatës, avokatë, prokurorë publikë: vlerësimi 3,75 (në shkallë nga 1 deri 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë).




Anketë e gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publik

Te ky drejtim strategjik mund të bëhet krahasim me vitin 2018 në lidhje me indikatorët vijues:

1.1.4 Numri i mendimeve të miratuara nga ana e Gjykatës supreme për praktikën gjyqësore: Në vitin 2019, është zvogëluar numri i aktgjykimeve të publikuara – 9, për dallim nga viti 2018 -17.



Numri i aktgjykimeve të publikuara në vitin 2018




Numri i aktgjykimeve të publikuara në vitin 2019

Në vitin 2018, Gjykata supreme nuk ka miratuar mendime juridike parimore dhe qëndrime parimore. Për dallim nga ajo, në vitin 2019 u miratuan dhe u publikuan në internet dy mendime juridike parimore dhe katër mendime juridike dhe konkluzione. Në vitin 2019, njëjtë si në vitin 2018, Gjykata supreme nuk ka miratuar dhe publikuar qëndrime parimore.



Nuk janë publikuar qëndrime juridike parimore



Të publikuara 5 mendime juridike dhe konkluzione

Të publikuara 6 mendime juridike dhe konkluzion

- 1.1.6 Pjesa e trajnimeve që përfshijnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ose vendimet dhe rekomandimet e organeve të KB për të drejtat e njeriut: Në vitin 2019, 10%, ose 23 nga 222 trajnime të realizuara, janë trajnime që përfshijnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Për dallim nga kjo, në vitin 2018, 12%, ose 22 nga gjithsej 189 trajnime, janë trajnime që përfshijnë analiza të vendimeve të publikuara gjyqësore që përqendrohet lidhur me të drejtat e njeriut.
- 1.1.7 Përqindja e pjesëmarrësve në trajnimin e vazhdueshëm (gjykatës, prokurorë) që kanë kaluar trajnimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ: Në vitin 2019, përqindja u rrit në 46%, krahasuar me vitin 2018 e cila ishte 30%.
- 1.1.8 Përqindja e numrit të përgjithshëm të gjykatësve që marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm për të drejtën e BE-së: Në vitin 2019, numri i gjykatësve është rritur (45%) që kanë kaluar trajnimin për të drejtën e BE-së u rrit, krahasuar me vitin 2018, kur vetëm 5% e numrit të përgjithshëm kanë kaluar trajnimin e tillë.
- 1.1.9 Pjesëmarrja e trajnimeve që përfshijnë analizë të vendimeve të publikuara gjyqësore që fokusohet në rastet lidhur me të drejtat e njeriut: Në vitin 2019, u rrit numri i trajnimeve që përfshijnë analizë të vendimeve të publikuara gjyqësore që fokusohet në rastet lidhur me të drejtat e njeriut - 14% e numrit të përgjithshëm të trajnimeve, kundrejt 12% në vitin 2018.
- 1.1.10 Numri i takimeve të mbajtura ndërmjet gjykatësve nga rajone të ndryshme të apelit dhe Gjykatës supreme (për praktikën gjyqësore): Në vitin 2018, Gjykata supreme dhe gjykatat e apelit kanë mbajtur tre takime, në krahasim me vitin 2019, ku ata kanë mbajtur dy takime.

Drejtimi strategjik “Rishikimi i kriterëve për vlerësimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë” te të dy indikatorët mund të vërehet se, për dallim nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat nga viti 2018⁴ dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor nga viti 2018⁵, ka një përmirësim thelbësor me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat⁶ dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor,⁷ të cilat janë vlerësuar pozitivisht edhe nga Komisioni i Venecias.⁸ Në drejtimin e përzgjedhjes së kuadrove cilësorë në gjyqësor janë edhe zgjidhjet që kanë të bëjnë me dhënien e provimit pranues dhe përfundimtar në kuadër të trajnimit fillestar në projektligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, i cili u miratua nga Qeveria në korrik 2019.

Drejtimi strategjik “Sistemi funksional i shërbimit të provës dhe masa tjera alternative”, shërbimi i provës filloi aktivisht punën në vitin 2019 dhe atëherë u shënuan 165 raste. Ligji për shërbimin e provës ka një rëndësi të jashtëzakonshme për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prandaj, rekomandohet trajnim intensiv i gjykatësve për zbatimin e Ligjit për shërbimin e provës, sepse bashkëpunimi me shërbimin e provës mundëson qasje të drejtë në individualizimin e dënimit për çdo të akuzuar.⁹

Drejtimi strategjik “Monitorimi i rezultateve dhe cilësisë së noterisë”, janë monitoruar procedurat disiplinore të Dhomës së noterisë. Në Këshillin Disiplinor të Dhomës janë parashtruar pesëmbëdhjetë propozime për procedurë disiplinore kundër noterëve, nga të cilët 13 u shqyrtuan, me ç’rast u miratuan masat e disiplinore në vijim - pesë gjopa dhe pesë qortime publike. Për një lëndë është konstatuar se është parashkruar, ndërsa për një lëndë noteri është i liruar nga përgjegjësia. Këshilli Disiplinor i Dhomës së noterisë gjatë vitit 2019, ka vepruar edhe për pesë propozime për ngritjen e procedurave disiplinore nga viti 2018, me ç’rast u miratuan masa disiplinore - dy qortime publike. Për një lëndë është konstatuar se është parashkruar dhe për dy lëndë noteri është i liruar nga përgjegjësia.

4 „Gazeta Zyrtare“, nr. 83/2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

5 „Gazeta Zyrtare“, nr. 83/2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për këshillin gjyqësor.


6 „Gazeta Zyrtare“, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për gjykatat.

7 „Gazeta Zyrtare“, nr. 102/2019, Ligji për këshillin gjyqësor.

8 Mr Richard Barrett and others, ‘Opinion on the Draft Amendments to the Law on Courts, Adopted by the Venice Commission at Its 117th Plenary Session’ (Venice Commission 2018) Opinion No. 944 / 2018 <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)033-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)033-e)>; Mr Richard Barrett, Mr Philip Dimitrov and Ciril Ribičić, ‘Opinion on the Draft Law on the Judicial Council, Adopted by the Venice Commission at Its 118th Plenary Session’ (Venice Commission 2019) Opinion No. 947 / 2019 <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)008-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)008-e)>.


9 Iva Conevska and Ismail Kamberi, ‘Shadow Report on Chapter 23 for the Period June 2019 – March 2020 [Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën qershor 2019 – mars 2020]’ (European Policy Institute – Skopje 2020) <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/lzvestaj_vo_senka_2020.pdf>.

Drejtimi strategjik “Monitorimi i vazhdueshëm i efekteve nga përbarimi dhe i cilësisë së punës” është konstatuar ulje e shkallës së realizimit të dokumenteve përbaruese nga 55,7% në vitin 2018 në 44,5% në vitin 2019. Në vitin 2019, Komisioni Disiplinor i Dhomës së përbaruesve ka ngritur procedurë kundër tre përbaruesve, të cilët i ka shpallur fajtorë dhe u ka shqiptuar masa disiplinore: qortim publik, gjoha dhe heqje e përherëshme e të drejtës së kryerjes së detyrës përbarues (në një rast). Në vitin 2018, është ngritur procedurë kundër dy përbaruesve, të cilët janë shpallur fajtorë dhe u janë shqiptuar masa disiplinore – gjoha.



Drejtimi strategjik “Përdorimi i shpeshtë i ndërmjetësimit nga organet publike”, me qëllim të avancimit të konceptit të ndërmjetësimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në korrik 2019 miratoi Konkluzion¹⁰ i cili detyron të gjitha organet shtetërore, institucionet, ndërmarrjet publike që janë në pronësi të shtetit, por edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, para se të fillojnë procedurë para gjykatës për të bërë përpjekje për të zgjidhur kontestet përmes ndërmjetësimit. Megjithatë sipas të dhënave nga anketa, ka një rënie në numrin e personave të udhëzuar për ndërmjetësim nga organet publike dhe numrin e lëndëve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit, në të cilat palë janë organe publike për vitin 2019, megjithatë ky numër mund të jetë si rezultat i numrit të përgjithshëm të kontesteve në të cilat palë janë organe publike. Lidhur me këtë drejtim strategjik, situata është si vijon:

- 1.6.1 Numri i lëndëve të dërguar për ndërmjetësim nga organet publike: Ekziston ulje të numrit të lëndëve për të cilat ndërmjetësuesit janë përgjigjur se ua kanë dërguar organet publike në vitin 2019 (89 lëndë) në krahasim me vitin 2018 (128 lëndë).
- 1.6.2 Numri i lëndëve të zgjidhur me ndërmjetësim, në të cilat palë janë organet publike: Ekziston ulje të numrit të lëndëve të zgjidhur nga 82 në vitin 2018 në 58 në vitin 2019.



Drejtimi strategjik “Stimulimi i zbatimit të ndërmjetësimit në procedurat gjyqësore” mund të vërehet se ekziston avancim i konceptit të ndërmjetësimit me miratimin e Ligjit të ri për ndërmjetësim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 188/2013, 148/2015, 192 / 2015 dhe 55/2016). Duke analizuar kontestet dhe marrëveshjet e arritura për periudhën 2016-2019, mund të konkludohet se shkalla e suksesit të të gjitha lëndëve të ndërmjetësimit është 72% (nga gjithsej 1,570 lëndë, marrëveshje është arritur në 1,137 konteste). Përveç promovimit të konceptit të ndërmjetësimit, veçanërisht në fushën e kontesteve të punës dhe kontesteve ekonomike, është e nevojshme që përveç kësaj të shfrytëzohet ndërmjetësimi në përputhje me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve dhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Lidhur me këtë drejtim strategjik, situata është si vijon:


- 1.7.1 Numri i lëndëve të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve: Në vitin 2019, njëjtë si në vitin 2018, nuk janë dërguar lëndë për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve.
- 1.7.2 Numri i lëndëve të zgjidhura me ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve: Në vitin 2019, njëjtë si në vitin 2018, nuk janë dërguar lëndë për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve, dhe nuk ka as lëndë të zgjidhura.

¹⁰ Instituti për politikë evropiane, „Dokument për politika publike’ Implementimi i Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë 2017-2022“, (2019) <<https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/01/%D0%94%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%BE%D0%B3-%D0%B7%D0%B0-%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B8%D0%BA%D0%B8-%D0%B1%D1%80%D0%B8%D1%84.pdf>>.

1.7.3 Numri i lëndëve të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve: Rritja e numrit të lëndëve për të cilat ndërmjetësuesit janë përgjigjur se janë dërguar për ndërmjetësim në pajtim me këtë ligj në vitin 2019 (nëntë lëndë) krahasuar me vitin 2018 (katër lëndë).




1.7.4 Numri i lëndëve të zgjidhura me ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve: Rritja e numrit të lëndëve për të cilat ndërmjetësuesit janë përgjigjur se janë zgjidhur në pajtim me këtë ligj në vitin 2019 (tre lëndë) krahasuar me vitin 2018 (një lëndë).




1.7.5 Shkalla e suksesit të kontesteve ekonomike dhe të punës, të zgjidhura përmes ndërmjetësimit:

Shkalla e suksesit të kontesteve ekonomike të zgjidhura përmes ndërmjetësimit është 28,3% (nga gjithsej 567 lëndë, marrëveshje është arritur në 161).



Shkalla e suksesit të kontesteve të punës të zgjidhura përmes ndërmjetësimit është 99,60% (nga gjithsej 948 lëndë, marrëveshje është arritur në 945 lëndë).



2. REZYME PËR QËLLIMIN STRATEGJIK: EFIKASITET


Drejtimi strategjik “Monitorimi efiqasitetit të gjyqësorit përmes treguesve të përcaktuar në Listën e rezultateve të BE-së (EU Justice Scoreboard), SEREJ dhe standardeve tjera ndërkombëtare”: megjithëse Metodologjia e statistikës gjyqësore është pjesërisht e harmonizuar me treguesit përkatës të pranuar ndërkombëtarisht, ajo nuk zbatohet në praktikë, sepse institucionet në raportet e tyre të rregullta nuk ndjekin vlerat aktuale të treguesve të parapara në Metodologjinë. Kjo mangësi tejkalohet pjesërisht me ndihmën e shoqërisë civile, e cila monitoron disa vlerat e treguesve përkatës.

Drejtimi strategjik “Zbatimi konsekuent i Plan veprimit për zgjidhjen e lëndëve të vjetra dhe monitorimin e situatës me lëndë të pazgjidhura” te dy tregues mund të vërehet përmirësim krahasuar me vitin 2018:

2.2.4 Numri i lëndëve të vjetra: 2.852 në fund të vitit 2019, gjë që është ulje prej 27% në krahasim me vitin 2018 (3.921).



2.2.5 Numri i lëndëve në të cilat është konstatuar shkelja e parimit të gjykimin në afat të arsyeshëm: Numri i përgjithshëm i lëndëve para Gjykatës supreme në këtë fushë në vitin 2019 është ulur për 200, përkatësisht për 25% krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, numri i lëndëve në të cilat është konstatuar shkelje e këtij parimi është ulur për 165 nga 191 në vitin 2018.




Në vitin 2019, shkalla e zgjidhjes së lëndëve në instancën e parë (treguesi 2.2.2) është nën 100% (96.7%), që tregon rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Në vitin 2018, treguesi ka qenë 101.2%, përkatësisht në atë vit ka pasur rënie të numrit të lëndëve të mbetur. Arsyeja për rënie të ky tregues në vitin 2019 mund të gjendet në rritjen prej 11.4% të numrit të lëndëve të pranura në vitin 2019, që nuk ka mund të tejkalohet plotësisht me rritjen prej 6.2% të numrit të lëndëve që gjykatat i kanë zgjidhur gjatë vitit. Për këtë shkak, është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura (treguesi 2.2.1) dhe në fund të vitit 2019 u rrit me 8.6% krahasuar me fundin e 2018. Kjo rrit kohën e nevojshme për të zgjidhur çështjet e prapambetura në shkallën e parë (treguesi 2.2.3): Në vitin 2019, do të nevojiteshin 152.8 ditë për të zgjidhur lëndët e pazgjidhura në instancën e parë krahasuar me 147.7 ditë në vitin 2018.



Drejtimi strategjik “Harmonizimi i numrit të gjykatësve me mesataren evropiane për kokë banorë”, Te treguesi 2.3.1 Efikasiteti i shpenzimeve në zgjidhjen e lëndëve nuk mund të krahasohet me vitin 2018. Vlerat për vitin 2019 tregojnë se gjykata e apelit me efikasitet më të vogël shpenzon, mesatarisht, 33% më shumë për një lëndë të zgjidhur sesa gjykata e apelit me efikasitet më të lartë. Mesatarisht, për një lëndë të zgjidhur në gjykatën themelore me renditje të fundit shpenzohet 2.6 herë më shumë se gjykata themelore me . Treguesi 2.3.2 Shkalla e produktivitetit në zgjidhjen e lëndëve tregon përmirësim në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 te 16 gjykata themelore dhe dy gjykata të apelit, ndërsa ulje te 11 gjykata themelore dhe dy gjykata të apelit.

Drejtimi strategjik “Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimit gjyqësor dhe prokurorisë publike” nuk mund të krahasohet me vitin e kaluar, sepse vlera e treguesit u përcaktua me anketë. Profesionalizmin dhe kompetencën e bashkëpunëtorëve gjyqësorë profesionalë e kanë vlerësuar shpesh me notë 4 (46%) në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është nota më e lartë. Këtë notë (vlerësim) më shpesh e kanë dhënë edhe avokatët dhe prokurorët publik të anketuar (35%), por te ata gjithashtu ka edhe numër të konsiderueshëm përgjigjesh me notë 3 (34%).

PERCEPTIMI PËR PROFESIONALIZMIN DHE KOMPETENCËN E BASHKËPUNËTORËVE GJYQËSORË PROFESIONALË



Drejtimi strategjik “Funksionaliteti i plotë i ueb portalit www.sud.mk” mund të theksohen dy tregues:

2.5.2 Zbatim i standardeve për publikimin në internet të aktgjyqimeve. Shumica e gjykatësve (59%) dhe nëpunësve (53%) konsiderojnë se respektohen standardet për afatet për publikimin në internet të aktgjyqimeve, dhe rreth 40% se nuk respektohen. Lidhur me kënaqshmërinë nga publikimet në internet, shpesh të anketuarit e kanë vlerësuar me vlerësim mesatar (39% e gjykatës, 25% nëpunës dhe 27% e avokatë/prokurorë publikë). Lidhur me kënaqshmërinë nga kërkimi në internet të vendimeve gjyqësore, vlerësimi më i shpeshtë të gjykatësit dhe nëpunësit është 4 nga 5 të mundshme (përkatësisht 39% dhe 29%), ndërsa avokatët/prokurorët publikë shpesh kanë dhënë vlerësim mesatar prej 3 (23%).

2.5.3 Arritshmëria e informacioneve në internet për publikun në lidhje me sistemin e drejtësisë. Të arritshme janë llojet vijuese të informatave të synuara: a) formularë onlajn për publikun dhe kompanitë; b) informata të dedikuara për personat me shikim ose dëgjim të dëmtuar; c) informacione të dedikuara për personat që nuk flasin gjuhën maqedonase. Lidhur me arritshmërinë e informacioneve në internet për datën, kohën dhe numrin e sallave për seancë gjyqësore, për lëndë konkrete, rreth 46% e qytetarëve të anketuar janë të kënaqur nga informacioni i dhënë nga gjykata, dhe rreth 28% janë të pakënaqur dhe 18% madje nuk janë as kënaqur as të pakënaqur. Nuk janë të arritshme llojet vijuese të informacioneve të synuara: a) edukimi mbi të drejtat e qytetarëve në sistemin e drejtësisë përmes mjeteve ndërvepruese; b) terminalët kompjuterikë në gjykatat me qasje në internet të arritshme për qytetarët; c) simulimi interaktiv onlajn për të vlerësuar të drejtën për ndihmë juridike; c) informacione të dedikuara për fëmijë.

3. REZYME PËR QËLLIM STRATEGJIK: TRANSPARENCA


Drejtimi strategjik “Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave statistikore për punën e gjykatësve dhe prokurorëve publikë në KGJRM dhe KPPRM”: shënon status kuo.

3.1.1 Llojet e sistemeve të monitorimit dhe evaluimit të aktiviteteve gjyqësore:

- a) Raportet vjetore për punën e gjykatave; Gjykata Supreme dhe gjykatat e apelit publikojnë rregullisht raporte të tilla. Nga 27 gjykatat themelore, vetëm tetë kanë publikuar raporte vjetore për punën, një ka publikuar analizë për punën për lëndët, katër kanë publikuar vetëm statistikë vjetore për lëndët, pesë kanë publikuar statistikë mujore për lëndët, që nuk është përmbledhur në nivel vjetor, dhe nëntë nuk kanë publikuar kurrfarë raporti për punë. Kjo është përkeqësim i gjendjes krahasuar me vitin 2018, kur 12 gjykata themelore publikuan raporte vjetore, shtatë publikuan vetëm statistikë vjetore për lëndët, tri prej tyre publikuan statistikë mujore për lëndët, që nuk është përmbledhur në nivel vjetor, dhe pesë nuk kanë publikuar kurrfarë raporti për punën.
- b) Tregues për rezultate dhe cilësi: të përfshirë në Metodologjinë për statistikë gjyqësore
- c) Sistemi IT i menaxhimit me lëndët. Softueri AKMIR është instaluar në të gjitha gjykatat dhe me të bëhet evidenca, ndarja dhe monitorimi i lëvizjes së lëndëve gjyqësore në punën.
- ç) Sistemi IT për gjenerimin e statistikave për aktivitetet gjyqësore. Ekziston softuer për statistikën gjyqësore, i cili është i instaluar në Këshillin Gjyqësor, por funksionimi i tij është i diskutueshëm, sepse, me përjashtim të një treguesi, institucionet nuk publikojnë në raportet e tyre vlerat aktuale të treguesve të parapara me metodologjinë për statistikën gjyqësore. Të anketuarit u përgjigjën se Sistemi gjyqësor informativ (AKMIS) ka ose ka pjesërisht pesë lloje të të dhënave: 1) sa u përket të dhënave të nevojshme për të përgatitur raporte vjetore të gjykatave, të anketuarit më së shpeshti kanë vërtetuar që sistemi ka të dhëna të tilla (30%), 27% janë prononcuar pjesërisht, dhe 23% u përgjigjën negativisht; 2) për vjetërsinë e lëndëve nga 29% janë përgjigjur se sistemi ka të dhëna të tilla, përkatësisht se ka pjesërisht të dhëna, ndërsa 21% janë prononcuar se sistemi nuk ofron të dhëna të tilla; 3) për numrin e seancave të shtyra 32% e të anketuarve janë përgjigjur se sistemi informativ nuk ka të dhëna, 29% se ka të dhëna të pjesshme dhe vetëm 21% kanë menduar se ka të dhëna të tilla; 4) në lidhje me vlerën e treguesve nga metodologjia për statistikën gjyqësore, 25% janë përgjigjur se sistemi ka të dhëna pjesërisht, 22% që nuk ka të dhëna dhe 16% që ka; 5) për të dhëna tjera që janë të rëndësishme për mbajtjen e statistikës gjyqësore, 15% kanë konfirmuar që sistemi informativ ka të dhëna, 26% që ka pjesërisht, dhe 10% që nuk ka.
- d) Staf i specializuar gjyqësor për monitorim dhe evaluim. Një pjesë e nëpunësve gjyqësorë në gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor përgatisin raporte periodike për punën e gjykatave.
- dh) Anketat e realizuara ndërmjet shfrytëzuesve gjyqësorë dhe profesionistëve juridikë. Institucionet shtetërore nuk realizojnë anketa të tilla, por atë e bën periodikisht shoqëria civile.

Drejtimi strategjik “Përforcimi i kapaciteteve për marrëdhënie me publikun” mund të veçohen treguesit vijues:

3.2.1 Standardet për dhënien e informacioneve për rastet e palëve. Rreth 46% e qytetarëve të anketuar janë plotësisht ose pjesërisht të kënaqur me informacionin e dhënë nga gjykata për datën, kohën dhe numrin e sallës për gjykim për lëndën, dhe rreth 28% janë të pakënaqur. 41% janë pjesërisht ose plotësisht të kënaqur me informacionin se në cilën fazë është procedura për lëndën e tyre, rreth 35% janë plotësisht ose pjesërisht të pakënaqur. Sa i përket informacionit për shtyrjen e seancës gjyqësore, 38% e të anketuarve janë të kënaqur me informacionin e marrë, 37% janë të pakënaqur nga ai. 44% e të anketuarve janë të kënaqur nga arritshmëria e dokumentacionit të gjykatës për lëndën e tyre, ndërsa 33% janë të pakënaqur.



3.2.2 Transparenca e procedurave për publikun dhe kapaciteti i gjykatave për akomodimin e publikut dhe mediave. Në ndërtesën e re të Gjykatës Penale në Shkup - ku zhvillohen procedurat për të cilat ka zakonisht ka interes më të madh në nivel kombëtar - kushtet për publikun janë përmirësuar, por shpesh mediat dhe publiku i pranishëm në gjykime nuk janë në gjendje t'i ndjekin ato për shkak të audio sistemit të shkyqur.

3.2.3 Arritshmëria e trajnimeve për të punësuarit në gjykatat për lloje të ndryshme të komunikimit. Në vitin 2019, 62% e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të gjykatave kanë ndjekur trajnim të specializuar për kryetarë të gjykatave për marrëdhënie me publikun. 3% e numrit të mbetur të gjykatësve kanë ndjekur trajnim për marrëdhëniet me publikun.


Drejtimi strategjik “Barazimi i formës së raporteve vjetore për punën e gjykatave, prokurorive publike, KGJ dhe KPP” nuk është vërejtur përparim në procesin e rishikimit të metodologjisë për statistikën gjyqësore. Duke shikuar raportet e publikuara vjetore për punën e gjykatave, mund të vërehen dallime në strukturën e tyre, e ato nuk përmbajnë të dhëna për vlerën e treguesve të parapara me metodologjinë (me përjashtim të treguesit për numrin e përgjithshëm të lëndëve të mbetura), si dhe për kohëzgjatjen e procedurave sipas llojeve të lëndëve civile, përkatësisht baza për lëndë penale dhe periudhën e zgjidhjes, përkatësisht kohëzgjatjen e fazave të caktuara në procedurat, rezultatet dhe masat në lëndët penale.

4. REZYME PËR SFERËN STRATEGJIKE: PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE KRIJIMI I POLITIKAVE

Drejtimi strategjik “Koordinimi i reformës në sektorin e drejtësisë”: te dy tregues ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm:

4.1.3 Shpeshësia e konsultimeve për ndryshimet ligjore që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sistemin e drejtësisë. Pjesa më e madhe e gjykatësve (54%) dhe avokatëve (64%) u janë përgjigjur se Qeveria ndonjëherë i konsulton ata kur bëhet fjalë për iniciimin e ndryshimeve ligjore që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sistemin e drejtësisë. Për dallim nga ajo, prokurorët shpesh (48%) janë përgjigjur se janë konsultuar rrallë.

4.1.4 Kapaciteti për buxhetim efikas të gjykatave dhe prokurorive publike. Kapaciteti për buxhetim efikas nga gjykatat, avokatët dhe prokurorët publikë shpesh (30%) e kanë vlerësuar me 4 në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më e mirë, dhe 26% kanë dhënë vlerësim mesatar prej 3. Kapaciteti për buxhetim efikas nga prokuroritë publike, avokatët dhe prokurorët publikë më shpesh (35%) e kanë vlerësuar me notën/vlerësimin më të ulët 1, dhe 27% kanë vlerësuar me 3.



Te tre treguesit tjerë për këtë drejtim strategjik nuk ka nevojë për ndryshim në krahasim me vitin 2018:

4.1.1 Ekzistimi i njësisë funksionale ose stafit në Këshillin Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë për planifikim strategjik, monitorim dhe koordinim të reformës. Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë staf të mjaftueshëm për planifikim strategjik, monitorim dhe koordinim të reformës.

4.1.2 Ekzistimi i njësisë funksionale ose stafit në Këshillin Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë për analiza dhe hulumtime. Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë staf të mjaftueshëm për analiza dhe hulumtime.

4.1.5 Ndryshimi në gjendjen me planifikimin strategjik dhe krijimin e politikave në sektorin. Avokatët dhe nëpunësit gjyqësorë më shpesh janë përgjigjur se nga viti 2017 deri në vitin 2020 nuk ka ndryshim në gjendjen me planifikim strategjik dhe krijim të politikave në sektorin (përkatësisht 49% dhe 37%).

Drejtimi strategjik “4.2. Drejtimi strategjik: Monitorimi i implementimit të Strategjisë”

4.2.1 Numri i debateve të zhvilluara me palët e interesuara mbi rezultatet e implementimit të strategjisë. Në vitin 2019, u mbajtën katër seanca të Këshillit për implementimin e strategjisë për reforma në sistemin e drejtësisë.

4.2.2 Numri i rekomandimeve që dalin nga debatet për marrjen e masave korrigjuese: Janë identifikuar rekomandime në lidhje me gjashtë tema.

5. REZYME PËR SFERËN STRATEGJIKE: INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Drejtimi strategjik “Optimizimi i rrjetit gjyqësor“:

5.1.1 Numri i debateve të mbajtura për optimizimin e rrjetit gjyqësor: 1.



5.1.2 Numri dhe implementimi i rekomandimeve për optimizimin e rrjetit gjyqësor.

Në dhjetor 2018, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, u bë “Analizë e rrjetit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë“. Analiza u prezantua në seancën e dhjetë të Këshilli për monitorimin e implementimit të Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë, që u mbajt më 6 Shkurt 2019. Në drejtim të racionalizimit të gjykatave, siç është cekur në analizë më të detajuar për secilën gjykatë individualisht, e cila nuk është bërë deri më tani. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykatat nga viti 2019, e në bazë të kësaj analize, Gjykata Themelore në Gjevgjeli, Gjykata Themelore në Kavadarçë dhe Gjykata Themelore në Kërçovë nga viti 2020 janë gjykata me kompetencë të zgjeruar.

Drejtimi strategjik “Buxheti i pavarur dhe i qëndrueshëm gjyqësor, në përputhje me përcaktimin ligjor të të ardhurave kombëtare bruto“ te tre tregues shënohet përmirësim krahasuar me vitin 2018:

5.2.1 Shpenzimet e gjykatës: 0.29% të PBV-së në vitin 2019, që është një rritje në krahasim me vitin 2018, kur ka qenë 0.28% e PBV-së.

5.2.3 Struktura e buxhetit gjyqësor: Kategoria e rrogave dhe kompensimeve të rrogave me 72% në vitin 2019 shënon ulje krahasuar me vitin 2018, kur kjo kategori ka qenë pothuajse 80%. Shpenzimet kapitale (7.25%) shënojnë rritje të pjesëmarrjes në këtë kategori krahasuar me vitin 2018, kur kjo ka qenë vetëm 4.07%..



5.2.4 Përqindja e mbulimit të shpenzimeve reale për realizimin e drejtësisë nga buxhetet vjetore gjyqësore. Në vitin 2019, përfundimisht buxheti i aprovuari gjyqësorit është vetëm 66% nga ajo që është kërkuar, gjë që është një përmirësim krahasuar me vitin 2018, kur ky mbulim ka qenë 64%

Te një tregues nuk ka ndryshim:



5.2.2 Kriteret për përcaktimin e buxhetit gjyqësor: Megjithëse ekziston këshill i pavarur buxhetor gjyqësor, gjyqësori nuk arrin ta realizojë nivelin e nevojshëm të financimit.

Drejtimi strategjik “Rritja e kuadrit në shërbimin e prokurorisë publike“ kemi të dhëna për përlogaritjen e treguesit vetëm për vitin 2018 - shkalla e produktivitetit është 104 kallëzime penale të zgjidhura për prokuro.

6. REZYME PËR SFERËN STRATEGJIKE: SFERA NDËSHKIMORE-JURIDIK


Lidhur me drejtimin strategjik “Veprimi i drejtë duke forcuar të drejtat e mbrojtjes dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në procedurën penale”: ekzistojnë gjashtë tregues që janë vendosur në nivelin e drejtimit strategjik dhe me të cilët nuk mund të bëhet krahasim me vitin 2018:

6.1.1 Kënaqshmëria e palëve në lidhje me mundësinë e dhënë nga gjykata secilës palë për paraqitjen e dëshmime të tyre dhe për t'i kontestuar dëshmitë e palës së kundërt: Nga anketa e realizuar me qytetarë-pjesëmarrës në procedurën del se 41% e të anketuarve janë relativisht të kënaqur nga mundësia e paraqitjes dhe kontestimit të dëshmime që e kanë, ndërsa 32% janë relativisht të pakënaqur.



6.1.2 Perceptimi i palëve për atë se sa gjykatësit dhe prokurorët publikë i respektojnë të drejtat e të akuzuarve dhe viktimave: Nga anketa me avokatët dhe prokurorët publikë del se 90% e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht se prokurorët dhe gjykatësit i respektojnë të drejtat e të akuzuarve dhe të dëmtuarve në procedurat, kundrejt 10%.


TË DREJTAT E TË AKUZUARVE DHE TË DËMTUARVE NË PROCEDURAT QË RESPEKTOHEN?



6.1.3 Perceptimi i palëve për atë nëse gjykatësit i trajtojnë njerëzit drejt dhe në mënyrë të paanshme pavarësisht të ardhurave, origjinës etnike, origjinës sociale, gjinisë dhe religjionit: 58% e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht se gjykatësit i kanë trajtuar njëjtë pavarësisht të ardhurave të tyre, origjinës, gjinisë dhe religjionit, ndërsa 41% nuk pajtohen me këtë.


60% e të anketuarve pajtohen se stafi gjyqësor i kanë trajtuar njëjtë njerëzit.

TRAJTIM I BARABARTË I NJERËZVE PAVARËSISHT TË ARDHURAVE, ORIGJINËS, GJINISË, RELIGJIONIT




6.1.4 Perceptimet e palëve për atë nëse gratë viktima të dhunës seksuale dhe dhunës tjetër me bazë gjinore janë trajtuar në mënyrë të drejtë nga gjykatat: 53% të avokatëve dhe prokurorëve kanë punuar në lëndë të tilla. Të anketuarit që kanë punuar në lëndë të tilla u pyetën nëse bien dakord që gratë viktima të dhunës seksuale dhe dhunës tjetër me bazë gjinore janë trajtuar në mënyrë të drejtë në procedurë. Shumica e tyre, 62%, pajtohen plotësisht që gratë janë trajtuar në mënyrë të drejtë në procedurë. 38% pajtohen pjesërisht.

GRATË VIKTIMA NË PRICEDURAT PËR DHUNË SEKSUALE DHE DHUNË TJETËR ME BAZË GJINORE JANË TRAJTUAR DREJT




6.1.5 Perceptimi i palëve për respektimin e presumimit të pafajësisë: 40% e qytetarëve janë të kënaqur plotësisht ose pjesërisht nga respektimi i presumimit të pafajësisë nga gjykata, 36 % të pakënaqur, 14% as të kënaqur, as të pakënaqur. Pakënaqësia e madhe (50%) ekziston te qytetarët në lidhje me respektimin e presumimit të pafajësisë nga mediat.

KËNAQSHMËRIA NGA RESPEKTIMI I PRESUMIMIT TË PAFAJËSISË




6.1.6 Perceptimi për atë nëse gjykatësit janë të lirë të sjellin vendime pa ndërhyrje direkte ose indirekte nga Qeveria ose politikanët: Shumica e avokatëve dhe prokurorëve publikë (47%) besojnë se ekzekutivi shpesh ndërhyr në vendimet gjyqësore, ndërsa 34% kanë theksuar që atë shpesh e bëjnë edhe deputetët. Ndërsa shumica e gjykatësve kanë theksuar se nuk përballen me ndërhyrje në vendimarrje

SA SHPESH NDRËHYJNË GJATË SJELLJES SË VENDIMEVE GJYQËSORE?



SA SHPESH NDRËHYJNË GJATË SJELLJES SË VENDIMEVE GJYQËSORE?



Drejtimi strategjik “Veprim i drejtë me forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurën penale”: Dy tregues janë vendosur në nivelin e aktiviteteve dhe i referohen numrit të trajnimeve të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2019 për forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurën penale:

- 6.1.7 Numri i trajnimeve të planifikuara për gjykatës dhe prokurorë publikë të fokusuar në përforcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe në mbrojtjes së të drejtave në procedurën penale: 9 në vitin 2019.
- 6.1.8 Numri i trajnimeve të realizuara për gjykatësve dhe prokurorëve publikë të fokusuar në përforcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurën penale: 8 në vitin 2019.

Drejtimi strategjik “Përmirësimi i sistemit të drejtësisë së fëmijëve” gjendja është si vijon:

- 6.2.1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 14 deri në 18 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese më gjatë se një vit: 3 (përfundimisht me muajin shkurt 2020).
- 6.2.2 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 14 deri në 18 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese më gjatë se tre vit: 0 (përfundimisht me muajin shkurt 2020).
- 6.2.3 Numri i përgjithshëm i të rinjve të moshës 18 deri në 23 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese më gjatë se tre vjet: 3 Në pajtim me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve¹¹. „Në dhomën edukues-korrigjuese fëmija qëndron së paku një vit, dhe më së shumti pesë vjet, përkatësisht derisa të arrijë moshën 23 vjeçare“. Tre fëmijë të moshës 14 deri 23 vjeç vuajnë masën në Shtëpinë edukuese-korrigjuese Tetovë më gjatë se një vit.
- 6.2.4 Numri i përgjithshëm i fëmijëve viktimë të veprave penale kanë marrë ndihmë juridike falas gjatë vitit: Në vitin 2018 dhe 2019, në Ministrinë e Drejtësisë nuk janë dërguar kërkesa për miratimin e ndihmës juridike falas për fëmijët viktimë të veprave penale.
- 6.2.5 Numri dhe profili i ndjekësve të trajnimit të vazhdueshëm në AGJP që kanë kaluar trajnimin për trajtimin e fëmijëve viktimë: Në vitin 2018, më shumë ndjekës të trajnimit të vazhdueshëm në AGJP kanë kaluar trajnimin për trajtimin e fëmijëve viktimë, ndryshe nga viti 2019.
- 6.2.6 Numri i trajnimeve të mbajtura në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm në AGJP në lidhje me trajtimin e fëmijëve-viktimë: Në vitin 2018 ka më shumë trajnime të mbajtura në lidhje me trajtimin e fëmijëve-viktimë për dallim nga viti 2019.

¹¹ Neni 46 i Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, „Gazeta Zyrtare“, nr. 148/2013, 152/2019 dhe 275/2019.

7. REZYME PËR SFERËN STRATEGJIKE: SFERA JURIDIKE DHE E KUNDËRVAJTJE

Drejtimi strategjik “Parandalimi kundrejt represionit si qëllim themelor i procedurës për kundërvajtje” të dy treguesit i shënojnë vlerat vijuese:

7.1.1 Pjesëmarrja e masave parandaluese (zgjidhje, edukim) kundrejt masave represive (gjoba, barazimi, kallëzimi për kundërvajtje në numrin e përgjithshëm të masave të shqiptuara për mbikëqyrje inspektuese: 85%




7.1.2 Përqindja e lëndëve me procedurë të ngritur për barazim kundrejt lëndëve për të cilat është ngritur kallëzim për kundërvajtje: 64%




8. REZYME PËR SFERËN STRATEGJIKE: SFERA CIVILE-JURIDIKE

Drejtimi strategjik “Vendosja e sistemit të qëndrueshëm civil-juridik përmes plotësisht të vakumeve juridike ekzistuese dhe harmonizimit të tij me standardet evropiane dhe rrjedhat shoqërore moderne”: për së pari herë mblidhen të dhëna për treguesit në vijim:


8.1.1 Perceptimi i palëve për atë nëse gjykatësit i trajtojnë njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht të ardhurave, kombësisë ose origjinës sociale, gjinisë ose religjionit: Shumica e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht se gjykatësit dhe stafi gjyqësor i kanë trajtuar në mënyrë të barabartë pavarësisht të ardhurave, kombësisë, origjinës sociale, gjinisë ose religjionit. Rreth një e treta e qytetarëve dhe 13% e avokatëve nuk konsiderojnë se ekziston trajtim i barabartë.



8.1.2 Kënaqshmëria e palëve nga mundësia për t’i paraqitur para gjykatës dëshmitë e tyre dhe për t’ia kontestuar ato palës tjetër: 59% e të anketuarve dhe 63% e avokatëve kanë qenë relativisht të kënaqur nga mënyra se si u është mundësuar t’i paraqesin dëshmitë. 14% e qytetarëve kanë qenë relativisht të pakënaqur, ndërsa 23% e qytetarëve dhe 38% e avokatëve nuk kanë qenë as të kënaqur as të pakënaqur.



8.1.3 Kënaqshmëria e palëve nga ajo se si i ka dëgjuar gjykatësi dëshmitarët: 53% e të anketuarve dhe gjysma e avokatëve kanë qenë të kënaqur nga mënyra se si i ka dëgjuar gjykatësi palët. 16% e qytetarëve kanë qenë relativisht të pakënaqur, ndërsa 18% e qytetarëve dhe 50% e avokatëve nuk kanë qenë as të kënaqur as të pakënaqur.



8.1.4 Kënaqshmëria e palëve nga kohëzgjatja e procedurës: 45% e të anketuarve që kanë marrë pjesë në procedurë gjyqësore e civile nuk janë të kënaqur nga kohëzgjatja e saj. Pjesa më e madhe e avokatëve të anketuar (44%) e kanë vlerësuar me 3 kënaqshmërinë e tyre nga kohëzgjatje e procedurave gjyqësore nga 1 deri në 5.

8.1.5 Numri i gjykatave në faqen e internetit të të cilave janë publikuar të dhënat për shpenzimet e nevojshme për udhëheqjen e procedurave: Gjykata Supreme dhe gjykatat e apelit nuk kanë publikuar të dhëna të tilla.

Në lidhje me shpenzimet për vërtetime, certifikata ose verifikime të ndryshme: 13 gjykata themelore kanë publikuar shpenzime dhe të dhëna për llogari të pagueshme; një ka publikuar shpenzime, por ka informata për llogari të pagueshme për certifikata nga evidenca ndëshkimore; pesë kanë publikuar shpenzime dhe llogari të pagueshme për një pjesë të certifikatave; dhe tre kanë publikuar vetëm llogari të pagueshme, por jo edhe informata për shpenzimet. Pesë gjykata themelore nuk kanë publikuar kurrfarë informatash për këto shpenzime.

Në lidhje me shpenzimet për procedura dhe paushallë tjera : dy gjykata themelore kanë publikuar shpenzime dhe të dhëna për fletëpagesa; një ka publikuar vetëm informata për shpenzimet, por jo edhe llogaritë e pagueshme; tetë kanë publikuar vetëm llogari të pagueshme, por jo edhe informata për shpenzimet; një ka publikuar vetëm të dhëna për procedurën trashëgimor e; 15 gjykata nuk kanë publikuar kurrfarë të informatash.



***PASQYRA E
TREGUESVE SIPAS
QËLLIMEVE DHE
SFERAVE STRATEGJIKE***

1. QËLLIMI STRATEGJIK: CILËSIA

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
1.1 DREJTIMI STRATEGJIK: BARAZIMI I PRAKTIKËS GJYQËSORE (DREJTIMI 2.2.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSIS)			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	1.1.1 Perceptimi i kompetentëc së gjykatësve	4 (mirë, në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë) ¹²	Anketa e avokatëve dhe prokurorëve publikë
	1.1.2 Perceptimi i kompetentëc së prokurorëve	4 (mirë, në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë) ¹³	Anketa e gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë
	1.1.3 Perceptimi i zbatimit të standardeve për përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore	3,75 (në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë). Vlerësimi u referohet gjashtë standardeve vijuese: monitorimi i praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (përgjigjja më e shpeshtë, në 37% të rasteve, është se zbatohet pjesërisht), ekzistimi i mekanizmave të brendshme në gjyqësor për vlerësimin e cilësisë së përgjithshme të aktgjyqimeve (përgjigjja më e shpeshtë, në 51% të rasteve, është se zbatohet pjesërisht), trajnimi për gjykatësit për strukturën e vendimeve, për stilin e arsytimit të vendimeve dhe për shkrimin e aktgjyqimeve (përgjigjja më e shpeshtë, në 38% të rasteve, është se ekziston pjesërisht), konciziteti i vendimeve të gjykatës (përgjigjja më e shpeshtë, në 51% të rasteve, është se respektohen), respektimi i elementeve të paracaktuara që duhet t'i përmbajë arsyetimi ose struktura e vendimit (përgjigjja më e shpeshtë, në 76% të rasteve, është se ato respektohen), përdorimi i gjuhës së qartë dhe të thjeshtë në vendimet (përgjigjja më e shpeshtë, në 66% të rasteve, është se ekziston pjesërisht). ¹⁴	Anketa e gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë
	1.1.4 Numri i mendimeve të miratuara nga ana e Gjykatës Supreme për praktikën gjyqësore	Në vitin 2018, pesë mendime juridike dhe 17 sentenca u miratuan dhe u publikuan në faqen e internetit. Në vitin 2018, Gjykata Supreme nuk ka miratuar dhe publikuar mendime juridike parimore dhe qëndrime parimore. Në vitin 2019, u miratuan dhe u publikuan në faqen e internetit dy mendime juridike parimore, katër mendime dhe konkluzione juridike dhe nëntë sentenca u miratuan dhe u botuan në faqen e internetit. Në vitin 2019, Gjykata Supreme nuk miratoi dhe publikoi qëndrime parimore.	Raporti vjetor i Gjykatës Supreme për vitin 2018 ¹⁵ dhe raporti vjetor i Gjykatës Supreme për vitin 2019 ¹⁶

12 4 është vlerësimi që e kanë dhënë më shpesh avokatët dhe prokurorët e anketuar publikë (48%). Për dallim nga ajo, 54% nga gjykatësit e anketuar kanë dhënë vlerësimin më të lartë (5) për profesionalizëm dhe kompetencë të kolegëve të tyre. Si tregues më objektiv është marrë vlerësimi i avokatëve dhe prokurorëve publikë.

13 4 është vlerësimi që e kanë dhënë më shpesh gjykatësit e anketuar (55% në lidhje me prokurorët publikë dhe 34% në lidhje me avokatët). Në përgjigjet e avokatëve dhe prokurorëve të anketuar publikë, gjithashtu dominon vlerësimi 4 për profesionalizëm dhe kompetencë të kolegëve të tyre.

14 Për secilin nga gjashtë standardet, të anketuarit kishin mundësinë të përgjigjen se standardi zbatohet, zbatohet pjesërisht ose nuk zbatohet. Nga këto tre përgjigje të mundshme, u mor parasysh ajo për të cilën gjykatësit dhe avokatët / prokurorët publikë më së shpeshti janë prononcuar. Përfashtim është bërë te përgjigjet për ekzistimin e trajnimit për gjykatësit mbi strukturën e vendimeve, stilin e arsytimit të vendimeve dhe shkrimin e aktgjyqimeve, ku vetëm përgjigjet e gjykatësve janë marrë parasysh si më relevante- ata vetë e dinë më mirë se çfarë trajnime kanë. Për të arritur te një vlerësim përmbljedhës, për secilin standard ku përgjigjja më e shpeshtë ka qenë se respektohet, është dhënë 1 pikë, nëse përgjigjja më e shpeshtë është se respektohet pjesërisht, është dhënë gjysmë pikë, ndërsa nëse përgjigjja më e shpeshtë është se nuk respektohet, nuk janë dhënë pika për atë standard. Pikat për standardet e ndryshme janë mbledhur, shuma është pjesëtuar me 6 (vlerësimi maksimal përmbljedhës nëse zbatohen të gjitha standardet), kështu që herësi shumëzohet me 5 për të marrë vlerësimin në shkallë nga 1 deri në 5.

15 Raporti vjetor për vitin 2018 është i arritshëm në shorturl.at/yUY19.

16 Raporti vjetor për vitin 2018 është i arritshëm në shorturl.at/guA23.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.1 DREJTIMI STRATEGJIK: BARAZIMI I PRAKTIKËS GJYQËSORE (DREJTIMI 2.2.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
1.1.5 Përqindja e gjykatësve që marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm për lloje të ndryshme të shkathtësive	Në trajnime lidhur me drejtimin dhe udhëheqjen me gjykatën, si dhe me etikën në vitin 2019 kanë marrë pjesë 117 gjykatës, përkatësisht kryetarë të gjykatave, gjë që është 23% e numrit mesatar të gjykatësve për vitin 2019 (512 gjykatës). ¹⁷	Përgjigje nga AGJPP kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe raport vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 ¹⁸
1.1.6 Pjesëmarrja në trajnimet që e përfshijnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ ose vendime dhe rekomandime për të trupave për të drejtat e njeriut të KB.	Në vitin 2019, 10% ose 23 nga gjithsej 222 trajnime të zhvilluara, janë trajnime që e përfshijnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Në vitin 2018, 12%, ¹⁹ ose 22 ²⁰ nga gjithsej 189 trajnime, janë trajnime për praktikën gjyqësore të GJEDNJ.	Përgjigje nga AGJPP kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, raport vjetor për punën e AGJPP për vitin 2018
1.1.7 Përqindja e ndjekësve të trajnimit të vazhdueshëm (gjykatës, prokurorë dhe bashkëpunëtorë profesionalë) që kanë kaluar trajnim për praktikën gjyqësore të GJEDNJ	Në vitin 2019, ekziston përmirësim në lidhje me numrin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë që kanë kaluar trajnim për praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Në pajtim me të dhënat, nga numri i përgjithshëm mesatar i gjykatësve dhe prokurorëve publik 703 për vitin 2019, 46% kanë kaluar trajnimin për praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Nga këta, 286 janë gjykatës dhe 40 prokurorë publikë. Për dallim nga ajo, në vitin 2018 trajnim të tillë kanë kaluar 30% e numrit të përgjithshëm mesatar të gjykatësve dhe prokurorëve publik (ose gjithsej 216 nga 720).	Përgjigje nga AGJPP kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik; Raportet ²¹ të Këshillit Gjyqësor për vitin 2019, Këshilli i Prokurorit Publik për vitin 2018
1.1.8 Përqindja nga numri i përgjithshëm i gjykatësve që marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm për të drejtën e BE-së	Në vitin 2019, 45% të numrit të përgjithshëm mesatar të gjykatësve (ose gjithsej 232 nga 512) kanë marrë pjesë në trajnimin e vazhdueshëm për të drejtën e BE-së. Në vitin 2018, vetëm 5% (ose gjithsej 29 gjykatës nga numri mesatar i gjykatësve 529) kanë marrë pjesë në trajnimin e vazhdueshëm për të drejtën e BE-së.	Përgjigje e AGJPP kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe raporti për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 ²²

17 Në vitin 2019, 62% e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të gjykatave (21 nga 34) kanë marrë pjesë në trajnimin e specializuar për marrëdhëniet me publikun, dhe 3% e gjykatësve kanë marrë pjesë në trajnimin për marrëdhëniet me publikun. 44% e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të gjykatave (15 nga 34) kanë marrë pjesë në trajnim të specializuar mbi rolin e kryetarëve të gjykatave në menaxhimin dhe udhëheqjen e gjykatave, si dhe menaxhimin dhe organizimin e punës së gjykatësve dhe të punësuarve. 2% (tetë gjykatës) kanë marrë pjesë në trajnimin për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe punën organizative të gjyqësorit administrativ; 3% (17 nga 512 gjykatës) kanë marrë pjesë në menaxhimin e lëndëve dhe trajnimin për menaxhimin e sallës së gjykatës; 3% (16 nga 512) kanë marrë pjesë në trajnim për zbatimin e kodit etik; 5% (26 nga 512) kanë marrë pjesë trajnim për përgjegjshmërinë, efikasitetin dhe transparencën e gjyqësorit.

18 Të dhënat janë marrë nga raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 janë në lidhje me numrin mesatar të gjykatësve, që në vitin 2019 është 512. Sipas raportit të filimit të vitit 2019 ka pasur 518 gjykatës, ndërsa më 31 dhjetor 2019 ka pasur 506 gjykatës.

19 Në pajtim me raportin vjetor të Akademisë së gjykatësve dhe prokurorëve publikë për vitin 2018, të arritshëm në: https://jpacademy.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/godisen-izvestaj-za-2018_en-1.pdf#page=12&zoom=100,80,741.

20 Nga trajnimet e mbajtur, 20 janë këshillime në lidhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, u mbajtën edhe dy trajnime për trajnues.

21 Të dhënat nga raportet janë në lidhje me numrin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

22 Nga raporti i Këshillit Gjyqësor të dhënat janë nxjerrë në lidhje me numrin mesatar të gjykatësve për vitin 2018 dhe 2019.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
1.1 DREJTIMI STRATEGJIK: BARAZIMI I PRAKTIKËS GJYQËSORE (DREJTIMI 2.2.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR MASËN/AKTIVITETIN	1.1.9 Pjesëmarrja e trajnimeve në të cilat është përfshirë analizë e vendimeve të publikuara gjyqësore që fokusohet në rastet lidhur me të drejtat e njeriut	Në vitin 2019, 14% ose 32 nga gjithsej 222 trajnime të zhvilluara, janë trajnime në të cilat është përfshirë analizë e vendimeve të publikuara gjyqësore që fokusohet në raste lidhur me të drejtat e njeriut. Në vitin 2018, 12%, ²³ ose 22 ²⁴ nga gjithsej 189 trajnime, janë trajnime që përfshijnë analizë të vendimeve të publikuara gjyqësore që fokusohet në rastet lidhur me të drejtat e njeriut. Megjithatë, edhe në një pjesë të trajnimeve të mbetura të organizuara nga Akademia shpesh lëndë e analizës është edhe praktika gjyqësore dhe aktvendimet gjyqësore të GJEDNJ. ²⁵	Përgjigje e AGJPP kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik.
	1.1.10 Numri i takimeve të mbajtura ndërmjet gjykatësve nga rajonet e ndryshme të apelit dhe Gjykatës Supreme (për praktikën gjyqësore)	Në vitin 2019, gjykatat e apelit dhe Gjykata Supreme kanë mbajtur tre takime pune për barazimin e praktikës gjyqësore. ²⁶ Në vitin 2019, gjykatat e apelit dhe Gjykata Supreme kanë mbajtur dy takime pune për barazimin e praktikës gjyqësore.	Përgjigje nga Gjykata Supreme ndaj kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik; Raporti vjetor i Gjykatës Supreme për vitin 2018. ²⁷
	1.1.11 Numri i seancave të mbajtura të Gjykatës Supreme për praktikën gjyqësore	Në vitin 2019 janë mbajtur shtatë seanca të Gjykatës Supreme për praktikën gjyqësore.	Përgjigje nga Gjykata Supreme ndaj kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

23 Në pajtim me raportin vjetor të Akademisë së gjykatësve dhe prokurorëve publikë për vitin 2018, i arritshëm në: https://jpacademy.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/godisen-izvestaj-za-2018_en-1.pdf#page=12&zoom=100,80,741.

24 Nga trajnimet e mbajtura, 20 janë këshillime në lidhje me praktikën gjyqësore të KEDNJ, u mbajtën edhe dy trajnime për trajnues.

25 Në pajtim me përgjigjen të dorëzuar nga Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

Një takim pune "Koncepti i punës dhe harmonizimi i katër gjykatësve të apelit me Gjykatën Supreme", dy takime punenë të cilat janë harmonizuar qëndrimet për çështje të caktuara juridike për të cilat në praktikën gjyqësore Paraqiten vendime të ndryshme në rajone të ndryshme të apelit, me qëllim barazimin e zbatimit të ligjeve, përkatësisht harmonizimin e praktikës gjyqësore.

27 Raporti vjetor për vitin 2018 është i arritshëm në shorturl.at/yUY19.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.2. DREJTIMI STRATEGJIK: REVIDIMI I KRITEREVE PËR VLERËSIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIM TË GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË DREJTIMI 2.2.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMËN E SEKTORIT GJYQËSOR		
TREGUES PËR MASËN AKTIVITET	<p>1.2.1 Kriteria objektive dhe transparente për zgjedhjen e gjykatësve, bazuar në parimin e meritave, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin, dhe duke respektuar plotësisht parimet e barazisë gjinore dhe përfaqësimit të drejtë</p> <p>Kriteret themelore për zgjedhjen e gjykatësit janë përcaktuar në nenin 45 të Ligjit për Gjykatat²⁸. Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat nga viti 2018²⁹ është shtuar kushti për njohje aktive të tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht). Kushti i tillë u kritikua në mendimin e Komisionit të Venecias³⁰ si shumë i rëndë, me atë që në ndryshimet e fundit në Ligjin për gjykatat u zëvendësua me kushtin e njohjes së tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht). Në pajtim me Ligjin për gjykatat, një nga kushtet e zgjedhjes së gjykatësit është që personi të gëzojë reputacion, të ketë integritet për të kryer funksionin e gjykatësit dhe të ketë aftësi shoqërore për të kryer funksionin e gjykatësit, për të cilin realizohen testet e integritetit dhe testet psikologjike. Ky kusht është i nevojshëm edhe për pranimin e kandidatit për gjykatës për trajnimin fillestar në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe testi psikologjik dhe testi i integritetit jepen në kuadër të provimit pranues në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.³¹</p> <p>Kushtet e veçanta për zgjedhje të gjykatësit janë cekur në nenin 46 të Ligjit për gjykatësit. Në të dy raportet e grupit të ekspertëve të udhëhequr nga Pribe³² është cekur se Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë duhet të mbetet pika e vetme për hyrje në gjyqësorin dhe prokurorinë publike.</p>	<p>Analiza e dispozitave ligjore në dritën e mendimeve të Komisionit të Venecias dhe raporteve nga grupi i ekspertëve i udhëhequr nga Pribe</p>

28 Në ligjin është cekur se gjykatës mund të zgjidhet personi i cili i përmbush kushtet vijuese

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ta zotërojë aktivisht gjuhën maqedonase,
- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi shëndetësore që dëshmohet me vërtetim mjekësor,
- studime të kryera në drejtësi me 300 SETK kredi ose shkallë VII/1 të arsimit nga sfera e shkencave të drejtësisë ose diplomë të nostrifikuar nga studimet juridike jashtë vendit për 300 kredi të arritura,
- të ketë dhënë provimin e jurisprudence në Republikën e Maqedonisë,
- të njohë njërin prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht),
- në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm të mos ketë të shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër lidhur me ushtrimin e profesionit ose për vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej së paku gjashtë muajsh,
- punë praktike me kompjuterë, dhe
- të gëzojë autoritet, të posedojë integritet për ushtrimin e funksionit dhe të posedojë aftësi sociale për ushtrimin e funksionit gjyqësor, për të cilën realizohen teste për integritet dhe test psikologjik.

– Burimi: „Gazeta Zyrtare”, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatësit.

29 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 83/18, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatësit.

30 Richard Barrett and others, ‘Opinion on the Law Amending the Law on the Judicial Council and on the Law Amending the Law on Courts, Adopted by the Venice Commission at Its 116th Plenary Session’ (Venice Commission 2018) Opinion No. 927 / 2018 <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)>.

31 „Gazeta Zyrtare”, nr. 83/2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (n 2).

32 Senior Experts’ Group, ‘The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts’ Group on Systemic Rule of Law Issues Relating to the Communications Interception Revealed in Spring 2015’ (2015) <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf>; Senior Experts’ Group, ‘The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and Recommendations of the Senior Experts’ Group on Systemic Rule of Law Issues 2017’ (2017) <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_ro_l_issues_for_publication.pdf>.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.2. DREJTIMI STRATEGJIK: RISHIMI I KRITEREVE PËR VLERËSIM TË GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË (DREJTIMI 2.2.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR MASËN AKTIVITET	<p>Ky rekomandim nuk u implementua me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat nga viti 2018³³, sepse në gjyqësorin administrativ ende mund të zgjidheshin gjykatës personat që kanë përvojë në çështjet juridike në organ shtetëror me rezultate të konfirmuara në punën. Me ndryshimet e fundit në Ligjin për gjykatat³⁴ nga viti 2019, janë bërë ndryshime në lidhje me kriteret për zgjedhjen e gjykatësve, me ç'rast implementohen rekomandimet e dhëna nga grupi i ekspertëve të udhëhequr nga Pribe. Në pajtim me këto ndryshimeve³⁵, hyrja në gjyqësor do të bëhet ekskluzivisht përmes Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Përkatësisht gjykatës në gjykatat themelore mund të zgjidhen kandidatë që kanë përfunduar trajnimin fillestar në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Përfundimisht i vetëm është gjykatësi në gjykatën ndërkombëtare, i cili plotëson kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e gjykatësit, që të mund të zgjidhet gjykatës në gjykatë nga të gjitha shkallat.</p> <p>Garancitë për cilësinë e gjykatësve të zgjedhur në gjykatat themelore janë, gjithsesi, trajnimi fillestar që e kalojnë kandidatët në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Gjithashtu, gjatë pranimit në Akademi, të gjithë kandidatët japin provim pranues për të hyrë në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. „Qëllimi i provimit pranues është të përcaktojë nivelin e njohurive profesionale të nevojshme për ndjekjen e programit për trajnim fillestar.”³⁶ Me projektligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë,³⁷ që u miratua nga Qeveria në korrik të vitit 2019, ridefinohet mënyra e dhënies së provimit pranues dhe përfundimtar në bazë të matjeve dhe kriterëve objektive për vlerësimin e njohurive të kandidatëve.</p> <p>Lidhur me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të të gjitha komuniteteve në vend, në Ligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë është përcaktuar se përfaqësimi i drejtë dhe adekuat do të respektohet në përzgjedhjen e kandidatëve për pranim në trajnimin fillestar në Akademinë³⁸. Gjithashtu, ky princip themelor është përcaktuar edhe në nenin 7 të Projektligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë³⁹. Në pajtim me projektligjin,⁴⁰ Këshilli Drejtues e përcakton numrin e përgjithshëm të ndjekësve të trajnimit fillestar në bazë vendimeve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë për numrin e vendeve të lira për gjykatës dhe prokurorë publik në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike, në të cilat detyrimisht duhet të ndahet numri i ndjekësve nga radhët e qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve në vend, sipas kapaciteteve të Akademisë. Parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve realizohet në mënyrë që numri i ndjekësve nga radhët e qytetarëve që i përkasin të gjitha komuniteteve përcaktohet në lidhje me numrin e përgjithshëm të ndjekësve nga të gjitha rajonet e apelit⁴¹. Në mënyrë që të sigurohen kandidatë cilësorë, si në ligjin ekzistues, ashtu edhe në projektligjin, ndjekës të trajnimit fillestar janë personat që kanë dhënë provimin pranues.</p>	

33 „Gazeta zyrtare“, nr. 83/2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (n 2).

34 „Gazeta zyrtare“, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat. 35

35 „Gazeta zyrtare“, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat. 36

36 „Gazeta zyrtare“, nr. 20/2015, Ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.

37 Propozim-ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, i arritshëm në: <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

38 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 20/2015, Ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, 2015, neni 9.

39 Propozim-ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, i arritshëm në: <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

40 Propozim-ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, i arritshëm në: <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

41 Propozim-ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, i arritshëm në: <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.2. DREJTIMI STRATEGJIK: RISHIKIMI I KRITEREVE PËR VLERËSIMIN E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBIKË (DREJTIM 2.2.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
<p>1.2.2 Kriteria objektive dhe transparente për avancimin e gjykatësve (zgjedhja në gjykatë më të lartë, zgjedhja e kryetarit të gjykatës), bazuar në parimin e meritave, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin, dhe duke respektuar plotësisht parimet e barazisë gjinore dhe përfaqësimit të drejtë</p>	<p>Kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjykatësit janë cekur në nenin 46 të Ligjit për gjykatat. Në neni 47 të Ligjit për gjykatat rregullohen kushtet dhe procedura për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës. Me ndryshimet në Ligjin për gjykatat nga 2018⁴² nuk u bënë ndryshime thelbësore në lidhje me kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjykatësit në gjykatë më të lartë, dhe as në lidhje me kushtet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës. Për dallim nga ndryshimet e vitit 2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat nga viti 2019 u vlerësua pozitivisht nga Komisioni i Venecias. Me ndryshimet nga viti 2019⁴³, u bënë ndryshime në lidhje me kriteret për zgjedhjen e gjykatësve, përkatësisht u ndryshua neni 46 dhe neni 47 të Ligjit për gjykatat dhe u precizuan më qart kushtet për zgjedhjen (avancimin) e gjykatësve dhe zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.</p> <p>Megjithëse në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatësit është cekur se gjykatës në gjykatën themelore mund të zgjidhet person i cili ka kryer trajnim fillestar në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, në ligjin është paraparë edhe mundësia e gjykatësve që të aplikojnë në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë (themelore ose e apelit) nëse kanë katër vjet stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatën e shkallës së njëjtë (themelore dhe e apelit). Me këto ndryshime është rritur stazhi gjyqësor⁴⁴ i nevojshëm për zgjedhje të gjykatësit në gjykatën e apelit. Gjithashtu, për dallim nga zgjedhja paraprake⁴⁵, ku ishte paraparë mundësia për të konkurruar gjykatësit e gjykatës së apelit, Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative, me ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykatat⁴⁶ në Gjykatën Supreme mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej së paku gjashtë vjet stazh si gjykatës në gjykatën e apelit deri në paraqitjen e zgjedhjes dhe që nga ana e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë është vlerësuar pozitivisht, në pajtim me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.</p> <p>Për dallim nga vendimi paraprak, ku në gjyqësorin administrativ mund të zgjidhej gjykatës edhe personi që ka stazh në çështjet juridike në organ shtetëror me rezultate të vërtetuara në punë, sipas ndryshimeve të fundit në Ligjin për gjykatat në Gjykatën Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka së paku katër vjet stazh të pandërprerë gjyqësor si gjykatës në gjykatën themelore, ndërsa gjykatës i Gjykatës së Lartë Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka së paku gjashtë vjet stazh të pandërprerë gjyqësor si gjykatës në gjykatën e apelit ose administrative. Në këtë mënyrë, Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe gjatë zgjedhjes së gjykatësve në Gjyqësorin Administrativ. Gjithashtu, nga Komisioni i Venecias⁴⁷ është përshëndetur edhe rritja e stazhit gjyqësor nga tre në gjashtë vjet që gjykatës nga Gjykata Administrative të zgjidhet gjykatësi në Gjykatën e Lartë Administrative, ndryshimet e tilla janë në drejtim të zgjedhjes së gjykatësve më me përvojë në Gjykatën e Lartë Administrative.</p>	<p>Analiza e dispozitave ligjore në dritën e mendimeve të Komisionit të Venecias dhe raporteve të grupit të ekspertëve të udhëhequr nga Pribe</p>

42 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisëja”, nr. 83/18, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

43 „Gazeta zyrtare”, nr. 96/2019; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (n 8).

44 Në pajtim me zgjedhjen ekzistuese, nevojitet gjashtë vjet stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatën themelore, Gjykatën Administrative ose të Lartë Administrative deri në momentin e paraqitjes së zgjedhjes, e cila nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë vlerësohet pozitivisht, që personi të zgjidhet si gjykatës në Gjykatën e Apelit. Për dallim nga ajo, zgjedhja paraprake parashikonte që gjykatës i gjykatës së apelit mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej së paku katër vjet stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatën themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, i cili në vitin e fundit nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë u vlerësua me vlerësimin më të lartë pozitiv dhe në lidhje me personat e tjerë të paraqitur morën numrin më të lartë të pikëve, në përputhje me ligjin, ose një gjykatësi në Gjykatën Administrative ose Gjykatën e Lartë Administrative, e cila në vitin e fundit nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësimin më të lartë pozitiv dhe në krahasim me personat tjerë të paraqitur ka marrë numrin më të lartë të pikëve, në përputhje me ligjin “.

45 Vendimi i mëparshëm parashikonte që “gjykatës i gjykatës së apelit mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune së paku katër vjet stazh gjyqësor të pandërprerë si gjykatës në gjykatë themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, që vitin e kaluar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me notën më të lartë pozitive dhe në krahasim me personat tjetër të paraqitur ka marrë numrin më të lartë të pikëve, në përputhje me ligjin, ose një gjykatësi në Gjykatën Administrative ose Gjykatën e Lartë Administrative, i cili në vitin e fundit nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësimin më të lartë pozitiv dhe në krahasim me personat tjerë të paraqitur ka marrë numrin më të lartë të pikëve, në përputhje me ligjin “.

46 „Gazeta zyrtare”, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatësit (n 8).

47 Mr Richard Barrett and others, ‘Opinion on the Draft Amendments to the Law on Courts, Adopted by the Venice Commission at Its 117th Plenary Session’ (Venice Commission 2018) Opinion No. 944 / 2018 <[https://www.venicecoe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)033-e](https://www.venicecoe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)033-e)>.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.2. DREJTIMI STRATEGJIK: RISHIKIMI I KRITEREVE PËR VLERËSIM TË GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË (DREJTIMI 2.2.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR MASËN/AKTIVITETIN	<p>Me ndryshimet e fundit është paraparë që gjykatësi në gjykatën ndërkombëtare, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme për zgjedhje të gjykatës, të mund të zgjidhet gjykatës në gjykatën nga të gjitha shkallët.</p> <p>Për dallim nga vendimi paraprak, ku kryetar i gjykatës zgjidhet nga radha e gjykatësve, në kushte, në procedurë dhe në mënyrën në të cilën zgjidhet gjykatës në gjykatën përkatëse, në pajtim me vendimin e ri, „kryetar i gjykatës zgjidhet nga radha e gjykatësve që kanë së paku gjashtë vjet stazh të pandërprerë gjyqësore në gjykatë të shkallës së njëjtë ose më të lartë, në kushte dhe në një procedurë të përcaktuara me ligj, për një periudhë katër vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje në gjykatë të shkallës së njëjtë“. Në pajtim me mendimin e Komisionit të Venecias, ky vendim mund të hapë dilemë vetëm në lidhje me zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme,⁴⁸ përkatësisht nëse në përputhje me këtë kriter do të ketë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të mundshëm për këtë pozitë.</p> <p>Në të gjitha rastet e avancimit të gjykatësve nevojitet që kandidati të vlerësohet pozitivisht, në pajtim me ligjin për këshillin gjyqësor, me ç'rast i jepet e drejta e zgjedhjes Këshillit Gjyqësor. Gjithashtu, në pajtim me Ligjin e ri për këshillin gjyqësor⁴⁹ gjykatësit dhe kryetarët e gjykatave mund të vlerësohen në mënyrë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Vlerësimi i zakonshëm është në çdo katër vjet, ndërsa vlerësimi i jashtëzakonshëm i punës së gjykatës dhe kryetarit të gjykatës bëhet në rast kur gjykata konkurren për zgjedhje të gjykatës në gjykatë tjetër më të lartë, për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës ose për anëtar tjetër të Këshillit. Gjykatësi vlerësohet sipas rezultateve të përgjithshme të suksesit të arritur në punë përmes kriterëve të përcaktuara cilësore dhe kuantitative. Kriteret cilësore janë 60% krahasuar me ato kuantitative, të cilat janë 40% në formimin e vlerësimit të përgjithshëm. Përcaktimi i kriterëve cilësore kryhet nga komisionet pesë anëtarëshe të gjykatësve nga të gjitha gjykatat e apelit, përkatësisht nga gjykatë drejtpërdrejt më e lartë. Komisionet e tilla formohen nga Këshilli Gjyqësor sipas zgjedhjes së rastësishme, në mënyrë të rregulluar me akt nënligjor i miratuar nga Këshilli.⁵⁰</p> <p>Megjithëse Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor, që në draft-versionin mori mendim pozitiv nga Komisioni i Venecias,⁵¹ megjithatë në mendimin është cekur se pesha e parametrevë të ndryshëm të marrë parasysh gjatë vlerësimit të performancave duhet të mbahet nën revizion të vazhdueshëm. „Më e përshtatshme është që vlerat e tilla numerike të rregullohen në akt nënligjor të Këshillit Gjyqësor, sesa në vetë ligjin, që të mund t'i zbatojnë nëse është e nevojshme.“ Këshilli Gjyqësor, me mbështetjen e projekti të financuar nga Mbretëria e Hollandës, ndërsa i implementuar nga Qendra për Kërkime dhe Analiza Ligjore, si dhe me mbështetjen e projektit IPA „Mbështetje për reformat në sektorin e drejtësisë“, përpunon metodologji me tregues të kompleksitetit të lëndëve dhe rregullore të veçantë për vlerësimin, përkatësisht vlerësimin të gjykatësve. Kjo rregullore ka një rëndësi të veçantë për vlerësimin e gjykatave dhe gjykatësve, të cilat do të vlerësohen sipas kriterëve reale dhe objektive, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjeve. Për shkak të kësaj, është më e përshtatshme që për përgatitjen e kësaj rregullore për vlerësimin e gjykatësve, të gjithë gjykatësit dhe gjykatat në vend të japin kontributin e tyre.⁵²</p>	

48 Ibid.

49 „Gazeta zyrtare“,nr. 102/2019, Ligji për Këshillin Gjyqësor.

50 Ibid.

51 Mr Richard Barrett, Mr Philip Dimitrov and Ciril Ribičič, ‘Opinion on the Draft Law on the Judicial Council, Adopted by the Venice Commission at Its 118th Plenary Session’ (Venice Commission 2019) Opinion No. 947 / 2019 <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)008-e-](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)008-e-)>.

52 Raporti në hije për Kapitullin 23 për periudhën prill 2019 – mars 2020.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.2. DREJTIMI STRATEGJIK: RISHIKIMI I KRITEREVE PËR VLERËSIM TË GJYKATËVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË (DREJTIMI 2.2.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
	Në neni 43 të Ligjit për Gjykatat ⁵³ është cekur se “ gjatë zgjedhjes së gjykatësve dhe gjykatësve porotë nuk duhet të bëhet diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare dhe shoqërore, bindjeve politike dhe fetare, pasurisë dhe statusit shoqëror. “ Gjithashtu, “gjatë zgjedhjes së gjykatësve dhe gjykatësve porotë pa u shkelur kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve». Gjatë përcaktimit të numrit optimal të gjykatësve dhe gjykatësve porotë në vend, Këshilli Gjyqësor duhet ta zbatojë parimin e përfaqësimit adekuat dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. ⁵⁴	
Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.3. DREJTIMI STRATEGJIK: SISTEMI FUNKSIONAL I SHËRBIMIT TË PROVËS DHE MASA TJERA ALTERNATIVE (DREJTIMI 2.2.9 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIME STRATEGJIKE	1.3.1 Ndryshimi nëpërdorimin e shërbimit të provës ose masave tjera alternative Shërbimi i provës filloi punën në mënyrë aktive në vitin 2019, dhe gjatë vitit ka pasur 165 lëndë të provës. Shumica e tyre janë për mbikëqyrje të personave të dënuar të liruar me kusht nga vuajtja e dënimit me burg (111 lëndë), 43 lëndë janë për mbikëqyrje të personave të dënuar me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, për mbikëqyrje të kryerjes punës me dobi shoqërore ka një lëndë, ndërsa dhjetë lëndë janë me kërkesë të gjykatës për aplikimin e instrumentit për vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e raportit të shërbimit të provës me propozim të sanksionit më të përshtatshëm gjatë procedurës gjyqësore.	Përgjigje e Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve ndaj kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik

53 Ligji për gjykatësit „Gazeta zyrtare “, nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 и 198/2018 dhe „Gazeta zyrtare “,nr. 96/201

54 Në pajtim me nenin 44 të Ligjit për gjykatësit, „Gazeta zyrtare “, nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 и „Gazeta zyrtare“, nr. 96/2019.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.4. DREJTIMI STRATEGJIK I REZULTATEVE DHE CILËSISË SË NOTERISË (DREJTIM 2.6.4.3 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË) ⁵⁵		
TREGUES PËR REALIZIMIN E DREJTIMIT STRATEGJIK	<p>1.4.1 Numri i propozimeve për procedurat disiplinore ndaj noterëve të parashtruara në Dhomën e noterisë dhe numri i masave të miratuara disiplinore</p> <p>Në vitin 2019, në Këshillin Disiplinor të Dhomës së Noterisë janë parashtruar 15 propozime për procedurë disiplinore ndaj noterëve (12 të parashtruara nga ministri i Drejtësisë në bazë të mbikëqyrjeve dhe tre të parashtruara nga kryetari i Dhomës së Noterisë). Këshilli Disiplinor i Dhomës së Noterisë shqyrtoi gjithsej 13 propozime për ngritjen e procedurave disiplinore të parashtruara në vitin 2019 (dhjetë të parashtruara nga ministri i Drejtësisë dhe tre nga kryetari i Dhomës së Noterisë), me çrast miratoi masat disiplinore vijuese - pesë gjopa dhe pesë qortime publike. Për një lëndë është konstatuar parashkrimi, ndërsa për një lëndë është konstatuar noteri është liruar nga përgjegjësia.</p> <p>Këshilli Disiplinor i Dhomës së Noterisë gjatë vitit 2019 ka proceduar edhe nga pesë propozime për ngritjen e procedurave disiplinore nga viti i kaluar 2018 (katër propozime të parashtruara nga ministri i Drejtësisë dhe një i parashtruar nga kryetar i Dhomës së Noterisë), me çrast u miratuan masa disiplinore - dy qortime publike. Për një lëndë është konstatuar parashkrim dhe për dy lëndë noteri publik është liruar nga përgjegjësia.</p>	Informacion mbi zbatimin e Ligjit për noteri për vitin 2019, Ministria e Drejtësisë
Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
1.5. DREJTIMI STRATEGJIK: MONITORIMI I VAZHDUESHËM I EFEKTEVE DHE CILËSISË SË PUNËS (DREJTIMI 2.6.3.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË) ⁵⁶		
TREGUES PËR REALIZIMIN E DREJTIMIT STRATEGJIK	<p>1.5.1 Shkalla e realizimit të dokumenteve ekzekutuese</p> <p>44.5% në vitin 2019, që është një ulje në krahasim me shkallën e realizimit prej 55.7% në vitin 2018. Një arsye e mundshme për uljen e realizimit janë kritikën e fuqishme nga qytetarët në lidhje me shpenzimet e ekzekutimit, gjë që rezultoi në uljen e tarifave të përmbauesve dhe heqjen e arkëtimit të kategorive të caktuara të shpenzimeve.</p>	<p>Raporti vjetor për punën e përmbauesve në vitin 2019, Ministria e Drejtësisë</p> <p>Informacion mbi zbatimin e Ligjit për përbarim dhe mbikëqyrje ekzekutive mbi punën e përmbauesve në vitin 2018, Ministria e Drejtësisë</p>
TREGUES PËR REALIZIMIN E DREJTIMIT STRATEGJIK	<p>1.5.2 Numri i propozimeve të parashtruara në Dhomën e përmbauesve dhe numri i masave të miratuara disiplinore</p> <p>Në vitin 2019, Komisioni Disiplinor i Dhomës së Përmbauesve ngriti procedurë kundër tre përmbauesve, të cilët i shpalli fajtorë dhe u shqiptoi masa disiplinore: qortim publik, gjopa dhe heqje të përhershme të së drejtës për të kryer detyrën e përmbauesit (në një rast). Në vitin 2018, u ngrit procedurë kundër dy përmbauesve, të cilët i shpalli fajtorë dhe u shqiptoi masa disiplinore -gjopa.</p>	Vendime të publikuara disiplinore në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë

55 Ky drejtim strategjik është pjesë e qëllimit strategjik "Qasja në Drejtësi" të Strategjisë për reformë në sektorin e drejtësisë 2017-2022 me Plan veprim. Për shkak të lidhjes me konceptin e cilësisë, zbatuesit e projektit vendosën ta monitorojnë edhe këtë drejtim strategjik.

56 Ky drejtim strategjik është pjesë e qëllimit strategjik "Qasja në Drejtësi" të Strategjisë për reformë në sektorin e drejtësisë 2017-2022 me Plan veprim. Për shkak të lidhjes me konceptin e cilësisë, zbatuesit e projektit vendosën ta monitorojnë edhe këtë drejtim strategjik.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
1.6. DREJTIMI STRATEGJIK: PËRDORIMI I SHPESHTUAR I NDËRMJETËSIMIT NGA ORGANET PUBLIKE (DREJTIMI 2.6.5.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË) ⁵⁷			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	1.6.1 Numri i lëndëve të dërguara për ndërmjetësim nga organet publike	Ekziston zvogëlim i numrit të lëndëve që ndërmjetësit janë përgjigjur se ua kanë dërguar organet publike në vitin 2019 (89 lëndë) në krahasim me vitin 2018 (128 lëndë). Positive është që është rritur përqindja e ndërmjetësuesve që janë prononcuar se u janë dërguar lëndë nga organet publike, nga 36% në vitin 2018 në 50% në vitin 2019	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane
	1.6.2 Numri i lëndëve të zgjidhura me ndërmjetësim, në të cilat palët janë organe publike.	Është vërejtur ulje të numrit të lëndëve të zgjidhura nga 82 në vitin 2018 në 58 në vitin 2019.	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane

57 Ky drejtim strategjik është pjesë e qëllimit strategjik „Qasje në drejtësi “e Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë 2017-2022 me plan veprimin. Për shkak të lidhshmërisë me konceptimin e cilësisë, implementuesit e projektit vendosën ta monitorojnë drejtimin strategjik.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
1.7. DREJTIMI STRATEGJIK: STIMULIMI I NDËRMJETËSIMIT NË PROCEDURAT GJYQËSORE (DREJTIMI 2.6.5.3 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË) ⁵⁸			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	1.7.1 Numri i lëndëve të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve	Në vitin 2019, gjithashtu edhe në vitin 2018, nuk ka lëndë të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve.	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane
	1.7.2 Numri i lëndëve të zgjidhura për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve	Në vitin 2019, gjithashtu edhe në vitin 2018, nuk ka lëndë të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve, dhe nuk ka as lëndë të zgjidhura.	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane
	1.7.3 Numri i lëndëve të dërguara për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve	Ekziston rritje të numrit të lëndëve për të cilët ndërmjetësuesit janë përgjigjur se janë dërguar për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të konsumatorëve në vitin 2019 (nëntë lëndë) në krahasim me vitin 2018 (katër lëndë). ⁵⁹	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane
	1.7.4 Numri i lëndëve të zgjidhura për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve	Ekziston rritje të numrit të lëndëve për cilat ndërmjetësuesit janë përgjigjur se janë zgjidhur në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve në vitin 2019 (tre lëndë) krahasuar me vitin 2018 (një lëndë).	Anketë me ndërmjetësues. Anketa u realizua në mënyrë elektronike në shkurt 2020. Anketës iu përgjigjën 22 ndërmjetësues. Anketa u realizua nga Instituti për Politikë Evropiane
	1.7.5 Shkalla e suksesit të kontesteve ekonomike dhe të punës, të zgjidhura përmes ndërmjetësimit	Me futjen e konceptit të ri të ndërmjetësimit në pajtim me miratimin e Ligjit të ri për ndërmjetësim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 188/2013, 148/2015, 192/2015 dhe 55/2016), koncepti i ndërmjetësimit është përmirësuar dukshëm. Ndryshimet në Ligjin për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 124/2015) u fut tentim i detyrueshëm për ndërmjetësim në kontestet tregtare për kërkesë monetare vlera e së cilës nuk tejkalon 1.000.000 denarë. Duke analizuar kontestet dhe marrëveshjet e arritura për periudhën 2016 - 2019, mund të konkludohet se shkalla e suksesit të të gjitha lëndëve të ndërmjetësimit është 72% (nga gjithsej 1,570 lëndë, u arrit marrëveshje në 1,137 konteste). Shkalla e suksesit të kontesteve ekonomike të zgjidhura përmes ndërmjetësimit është 28.3% (nga gjithsej 567 lëndë, marrëveshje u arrit në 161), ndërsa shkalla e suksesit të kontesteve të punës të zgjidhura me ndërmjetësim është 99.6% (nga gjithsej 948 lëndë, marrëveshje u arrit në 945 lëndë).	Pasqyra e të dhënave të marra nga Ministria e Drejtësisë

58 Ky drejtim strategjik është pjesë e qëllimit strategjik "Qasja në Drejtësi" të Strategjisë për reformë në sektorin e drejtësisë 2017-2022 me Plan veprim. Për shkak të lidhjes me konceptin e cilësisë, zbatuesit e projektit vendosën ta monitorojnë edhe këtë drejtim strategjik.

59 Megjithatë, është zvogëluar përqindja e ndërmjetësuesve që janë prononcuar se kanë lëndë në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve nga 14% në 2018 në 9% vitin 2019.

2. QËLLIMI STRATEGJIK: EFIKASITETI

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
2.1. DREJTIMI STRATEGJIK: MONITORIMI I GJYQËSORIT PËRMES TREGUESVE TË PËRCAKTUAR NË EU JUSTICE SCOREBOARD (LISTA E REZULTATEVE), STANDARDE SEREJ DHE STANDARDE TJERA NDËRKOMBËTARE (DREJTIM 12.4.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË SEKORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIM STRATEGJIK 2.1.1 Zbatimi i Metodologjisë për statistikë gjyqësore me standardin SEREJ	Megjithëse Metodologjia e statistikave gjyqësore është harmonizuar pjesërisht me treguesit përkatës të pranuar ndërkombëtarisht, ajo nuk zbatohet në praktikë, sepse institucionet në raportet e tyre të rregullta nuk i monitorojnë vlerat aktuale të treguesve të paraparë me Metodologjinë. Kjo mangësi pjesërisht tejkalohet me ndihmën e shoqërisë civile, e cila monitoron një pjesë të vlerave të treguesve përkatës.	Analiza e raporteve të rregullta të gjykatësve dhe Këshillit Gjyqësor

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
2.2. DREJTIMI STRATEGJIK: REALIZIMI KONSEKUENT I PLAN VEPRIMIT PËR ZGJIDHJEN E LËNDËVE TË VJETRA DHE MONITORIMIN E GJENDJES ME LËNDËT E PAZGJIDHURA (DREJTIMI 2.4.2 NË STATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
2.2.1 Numri i lëndëve të pazgjidhura	Në fund të vitit 2019, ka 73,550 lëndë të pazgjidhura, që është rritje prej 5,828 lëndësh, ose 8.6%, krahasuar me fundin e vitit 2018. Arsyeja e rritjes së këtij treguesi në vitin 2019 mund të gjendet në rritjen prej 11.4% të numrit të lëndëve të pranuar në vitin 2019, gjë që nuk mund të tejkalohet plotësisht me rritjen prej 6.2% të numrit të lëndëve që gjykatat i kanë zgjidhur gjatë vitit. Shikuar sipas instancave, lëndët e pazgjidhura janë rritur për 9.4% në instancën e parë dhe 7.5% në instancën e dytë. Ulje të lëndëve të pazgjidhura në vitin 2019 ka te Gjykata Supreme për 4.5% krahasuar me vitin 2018	Ministria e Drejtësisë
2.2.2 Shkalla e zgjidhjes së lëndëve në instancën e parë	96.5%; shkalla e zgjidhjes së lëndëve në instancën e parë tregon se në vitin 2019 numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur. Në vitin 2018, shkalla e zgjidhjes ka qenë 101.2%, përkatësisht në atë vit ka pasur ulje të numrit të lëndëve të mbetura. Arsyeja e uljes së këtij treguesi në vitin 2019 mund të gjendet në rritjen e numrit të lëndëve të pranuar në vitin 2019.	Ministria e Drejtësisë
2.2.3 Koha e nevojshme për zgjidhjen e lëndëve tjera në instancën e parë	152.8 ditë; ky është numri i ditëve të kërkuara për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura në instancën e parë. Treguesi shënon rritje krahasuar me vitin 2018, kur ka qenë 147.7 ditë. Arsyeja e uljes së këtij treguesi në vitin 2019 mund të gjendet në rritjen e numrit të lëndëve të pranuar në vitin 2019.	Ministria e Drejtësisë
2.2.4 Numri i lëndëve të vjetra	2,852 në fund të vitit 2019, që është ulje prej 27% krahasuar me vitin 2018 (3,921). Sipas kategorive, lëndët e vjetra janë reduktuar: <ul style="list-style-type: none"> - më të vjetër se tre vjet për pothuajse 60%, - më të vjetër se shtatë vjet për 46%, - më të vjetër se dhjetë vjet për një të katërtën. Në të gjitha tre kategoritë, shkalla e lëndëve të zgjidhura është rritur	Raporti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019
2.2.5 Numri i lëndëve në të cilat është konstatuar shkelje e parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm	Numri i përgjithshëm i çështjeve para Gjykatës Supreme në këtë fushë në vitin 2019 është ulur për 200, pra për 25% krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, numri i lëndëve në të cilat është konstatuar shkelje e këtij parimi është ulur për pothuajse 14% - në 165 nga 191 në vitin 2018. Megjithatë, në vitin 2019 shkalla e lëndëve të tilla në të cilat është konstatuar shkelje është rritur në 27% krahasuar me 24% në vitin 2018.	Raporti i Gjykatës Supreme për vitin 2019

TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK

EFIKASITETI

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
2.3. DREJTIMI STRATEGJIK: HARMONIZIMI I NUMRIT TË GJYKATËSVE ME MESATARE EVROPIANE PËR KOKË BANORË (DREJTIMI 2.4.3 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIMË STRATEGJIKE	2.3.1 Efikasiteti i shpenzimeve gjatë zgjidhjes së lëndëve	Gjykata e apelit më pak efikase shpenzon, mesatarisht, 33% më shumë në një lëndë të zgjidhur sesa gjykata e apelit me efikasitet më të lartë në shpenzim. ⁶⁰
	2.3.2 Shkalla e produktivitetit në zgjidhjen e lëndëve	Krahasuar me vitin 2018, dy gjykata të apelit shënojnë rritje të produktivitetit dhe dy ulje të produktivitetit (lëndë të zgjidhura mesatarisht për një gjykatës). 16 gjykata themelore shënuan rritje dhe 11 ulje të shkallës së produktivitetit. Shkalla e produktivitetit është 4.1 herë më e lartë se ajo e rangut të parë në krahasim me gjykatën në rangun e fundit. ⁶¹

60 Rangimi i gjykatave të apelit sipas efikasitetit të shpenzimeve (mjete të shpenzuara mesatarisht për lënë të zgjidhur) në vitin 2019: GJA Shkup (7.066 den.), GJA Manastir Shtip (9.389 den.). Për GJA Gostivar u siguruan të dhëna. Rang-lista e gjykatave themelore sipas efikasitetit të shpenzimeve (mjete të shpenzuara mesatarisht për lëndë të zgjidhur) në vitin 2019: GJTH Kumanovë (2,667 den.), GJTH Shën Nikollë (2,738 den.), GJTH Kërçovë (2,749 den.), GJTH Strumicë (2,905 den.), GJTH Radovish (2,958 den.), GJTH Kavadar (3,222 den.), GJTH Dellçevë (3,461 den.), GJTH Negotinë (3,971 den.), GJTH Vinicë (4,176 den.), GJTH Koçan (4,191 den.), GJTH Resnjë (4,290 den.), GJTH Berovë (4,912 den.), GJTH Manastir (5,010 den.), GJTH Kriva Pallankë (5 396 den.), GJTH Krushevë (6,852 den.). Për 12 gjykatat themelore tjera nuk u siguruan të dhëna.

61 Rangimi i gjykatave të apelit sipas shkallës së produktivitetit (lëndë të zgjidhura mesatarisht për gjykatës) në vitin 2019: GJA Shkup (449), GJA Shtip (409), GJA Gostivar (367), GJA Manastir (335). Rangimi i gjykatave themelore sipas shkallës së produktivitetit në vitin 2019: GJTH Delçevë (2,605), GJTH Dibër (2,108), GJTH Tetovo (2,107), GJTH Radovish (1,826), GJTH Kërçovë (1,745), GJTH Shën Nikollë (1,737), Gjykata Penale Shkup (1.689), GJTH Kumanovë (1.608), GJTH Berovë (1.561), GJTH Strumicë (1.525), GJTH Gostivar (1.515), GJTH Shtip (1.451), GJTH Koçan (1.433), GJTH Prilep (1.375), GJTH Kavadar (1,358), GJTH Resnjë (1,266), GJTH Strugë (1,216), GJTH Vinicë (1,191), GJTH Manastir (1,172), GJTH Veles (1,034), GJTH Ohër (938), GJTH Negotinë (915), GJTH Gjevgjeli (879), GJTH Kriva Pallankë (797), GJTH Krushevë (797), Gjykata Themelore Civile Shkup (753), GJTH Kratovë (632).)

Në vitin 2018, shkallat e produktivitetit janë si në vijim: GJA Shkup (427), GJA Shtip (404), GJA Gostivar (385), GJA Manastir (341), GJTH Dellçevë (2,390), GJTH Dibër (2,276), GJTH Radovish (1,789), GJTH Gostivar (1,784), Gjykata penale themelore Shkup (1.739), GJTH Kërçovë (1.707), GJTH Koçan (1.683), GJTH Shën Nikollë (1.535), GJTH Strumicë (1.457), GJTH Kumanovë (1.446), GJTH Prilep (1.377), GJTH Kavadar (1.304), GJTH Manastir (1,252), GJTH Strugë (1,241), GJTH Vinicë (1,232), GJTH Shtip (1,218), GJTH Berovë (1,146), GJTH Resnjë (1,079), GJTH Tetovë (1,071), GJTH Veles (1,012), GJTH Kriva Pallankë (998), GJTH Ohër (938), GJTH Gjevgjeli (893), GJTH Negotinë (795), Gjykata Themelore Civile Shkup (716), GJTH Kratovë (663), GJTH Krushevë (553)

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
2.4. DREJTIMI STRATEGJIK: PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TË SHËRBIMIT GJYQËSOR DHE TË PROKURORISË PUBLIKE (DREJTIMI 2.4.4 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK 2.4.1 Perceptimi i sjelljes, profesionalizmit të shërbimit gjyqësor	Profesionalizmin dhe kompetencën e bashkëpunëtorëve gjyqësorë profesionalë shpesh e kanë vlerësuar 4 (46%) në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë. Këtë vlerësim më shpesh e kanë dhënë avokatët dhe prokurorët e anketuar publikë (35%), por tek ata gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm të përgjigjeve me vlerësim 3 (34%). Nga qytetarët e anketuar që kanë qenë pjesëmarrës në ndonjë kontest, 71% janë përgjigjur se nuk ka ndodhur ose rrallë ka ndodhur që zgjatja e procedurave gjyqësore të jetë rezultat i gabimeve të stafit të gjykatës. 60% e qytetarëve të anketuar pajtohen se stafi i gjykatës trajton njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht nga të ardhurat, origjina, gjinia dhe religjioni, ndërsa 40% nuk pajtohen.	Anketa e qytetarëve-pjesëmarrës në procedurat gjyqësore, gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
2.5. DREJTIMI STRATEGJIK: FUNKSIONALITETI I PLOTË I UEB PORTALIT WWW.SUD.MK (DREJTIMI 2.4.5 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
2.5.1 Përqindja (pjesëmarrja) e aktgjykimeve të publikuara në portalin	Gjykatat ose nuk japin të dhëna për numrin e aktgjykimeve të publikuara ose mbajnë evidencë për aktgjykimet e publikuara gjatë disa viteve, e jo gjatë një viti.	
2.5.2 Zbatimi i standardeve për publikim onlajn të aktgjykimeve	Shumica e gjykatësve (59%) dhe nëpunësve (53%) konsiderojnë se respektohen standardet për afatet për publikimin onlajn aktgjykimeve, ndërsa rreth 40% se ato nuk respektohen. Në lidhje me kënaqshmërinë nga publikimi onlajn, të anketuarit më shpesh kanë dhënë vlerësim mesatar (39% gjykatës, 25% nëpunës dhe 27% avokatë / prokurorë publikë), nërsa vlerësimi i dytë më shpesh i përzgjedhur është më i larti 5 të gjykatësit (24%), përkatësisht 4 të nëpunësit, avokatët / prokurorët publikë (përkatësisht 21% dhe 19%). Lidhur me kënaqshmërinë nga kërkimi onlajn i vendimeve të gjykatës, vlerësimi më i shpeshtë të gjykatësit dhe nëpunësit është është 4 nga 5 të mundshme (përkatësisht 39% dhe 29%), ndërsa avokatët / prokurorët publikë më shpesh kanë dhënë vlerësim mesatar prej 3 (23%). Megjithatë, 15% e gjykatësve, 26% e nëpunësve dhe 24% e avokatëve / prokurorëve publik vlerësuan kënaqshmërinë nga kërkimi me vlerësimet më të ulëta 1 dhe 2.	Anketa e gjykatësve, nëpunësve gjyqësorë, avokatëve dhe prokurorëve publikë
2.5.3 Arritshmëria e informatave onlajn për sistemin e drejtësisë	<p>Të arritshme janë llojet e informatave të synuara në vijim: a) formularët onlajn për publikun dhe kompanitë - në sud.mk janë publikuar formularët - kërkesat dhe fletëpagesat për dokumente të ndryshme që i lëshon gjykata (vërtetime, çertifikata, etj.); b) informata të dedikuara për personat me shikim ose dëgjim të dëmtuar - portali sud.mk nuk është i përshtatur për këta persona, ndërsa megjithatë jep informata për personat e autorizuar përgjegjës për zbatimpersonave me invaliditet dhe mundësim të qasjes së dobishme në informata në gjykatë; c) informata të dedikuara për personat që nuk flasin gjuhë zyrtare - portali sud.mk është gjithashtu i arritshëm edhe në version rudimentar në anglisht. Nuk janë të arritshme llojet e informatave të synuara në vijim: a) edukimi mbi të drejtat e qytetarëve në sistemin e drejtësisë përmes veglave interaktive; b) terminalet kompjuterikë në gjykatat me qasje në internet të arritshëm për qytetarët; c) simulim interaktiv onlajn për të vlerësuar kualifikimin për ndihmë juridike - nuk është i arritshëm; në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë është publikuar informatë për atë se çfarë kushtesh duhet të plotësojë kërkuesi i ndihmës juridike falas, por me parametra të parashkruara; ç) informata të dedikuara për fëmijët - në faqet e disa gjykatave mundet vetëm të gjenden të dhëna të kontaktit për avokatët që janë të specializuar për drejtësinë e fëmijëve.</p> <p>Lidhur me arritshmërinë e informatave onlajn për datën, kohën dhe numrin e sallës për seancë për lëndën konkrete, rreth 46% e qytetarëve të anketuar janë të kënaqur nga informata e dhënë nga gjykata, dhe rreth 28% janë të pakënaqur dhe 18% nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur.</p>	Shqyrtimi i ueb faqeve të institucioneve të drejtësisë; Anketa e qytetarëve - pjesëmarrës në procedurast gjyqësore
2.5.4 Numri i vizituesve të ueb portalit		
2.5.5 Numri i vendimeve gjyqësore të publikuara në portalin	Në lidhur me publikimin onlajn të vendimeve gjyqësore, gjykatësit kënaqshmërinë më së shpeshti e kanë vlerësuar me vlerësim mesatar 3, në shkallë nga 1 deri në 5. 10% e gjyqtarëve janë të pakënaqur, dhe 46% janë pjesërisht ose plotësisht të kënaqur nga mënyra e publikimit. Kënaqshmëria me publikimin onlajn të vendimeve më së shpeshti është vlerësuar me vlerësim mesatar prej 3 edhe te nëpunësit gjyqësor (25%), si edhe te avokatët dhe prokurorët publikë (27%).	Anketa e gjykatësve, nëpunësve gjyqësorë, avokatëve dhe prokurorëve publikë.

3. QËLLIMI STRATEGJIK: TRANSPARENCA

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
3.1. DREJTIMI STRATEGJIK: Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave statistikore për punën e gjykatësve dhe prokurorive publike në KGJRM dhe KPPRM (DREJTIMI 2.5.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
3.1.1 Llojet e sistemeve për monitorimin dhe evaluimin e aktiviteteve gjyqësore	<p>Ekzistojnë llojet e sistemeve vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Raporte vjetore për punën e gjykatave; Gjykata Supreme dhe gjykatat e apelit publikojnë rregullisht raporte të tilla. Nga 27 gjykata themelore, vetëm tetë kanë publikuar raport vjetor për punën, një ka publikuar analizë për punën e lëndëve, katër kanë publikuar vetëm statistikë vjetore për lëndët, pesë kanë botuar statistikë mujore për lëndët, e cila nuk është përmbledhur çdo vit, dhe nëntë nuk kanë publikuar asnjë raport për punën. Ky është një përkeqësim i gjendjes krahasuar me vitin 2018, kur 12 gjykata themelore publikuan raporte vjetore, shtatë publikuan vetëm statistikë vjetore për lëndët, tre publikuan statistikë mujore për lëndët, e cila nuk është përmbledhur në nivel vjetor, dhe pesë nuk kanë publikuar asnjë raport të për punën. b) Treguesit për rezultatet dhe cilësinë; ekziston Metodologji e statistikës gjyqësore, por raportet e gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor nuk përmbajnë të dhëna për vlerën e treguesve të paraparë me metodologjinë (me përjashtim të treguesit për numrin e përgjithshëm të lëndëve të mbetura). Në raportet janë përfaqësuar parametrat dhe treguesit e mëposhtëm: numri i lëndëve të pranuar, lëndët e zgjidhura, lëndët e pazgjidhura, lëndët e vjetra. Nuk janë përfaqësuar tregues tjerë të rëndësishëm, si për shembull: shkalla e zgjidhjes, koha e nevojshme e zgjidhjes së lëndëve të mbetura, vjetërsia mesatare e lëndëve të zgjidhura ose të pazgjidhura ose kategorizimi i tyre sipas vjetërsisë, numri / përqindja e vendimeve të ankimuara, numri i seancave të shtyra. Megjithatë metodologjia deklaroi se do të mundësojë informata të krahasueshme për cilësinë, megjithatë ekziston përshtypje se cilësia perceptohet kryesisht përmes prizmit të kohëzgjatjes së procedurave, si dhe krahasimeve të përjashtimeve të kohëzgjatjes nga afatet ligjore për kohëzgjatjen e procedurave. c) Sistemi IT për menaxhimin me lëndët. Softueri AKMIS është instaluar në të gjitha gjykatat dhe me të bëhet evidenca, ndarja dhe monitorimi i lëvizjes së lëndëve gjyqësore në punën. ç) Sistemi IT për gjenerimin e statistikës për aktivitetet gjyqësore. Ekziston softuer për statistikën gjyqësore, i cili është i instaluar në Këshillin Gjyqësor, për funksionalitetin e të cilit nevojitet futja e plotë dhe e saktë e të dhënave në AKMIS. Funksionimi i sistemit për gjenerimin e statistikës gjyqësore është i diskutueshëm, sepse, me përjashtim të një treguesi, institucionet nuk publikojnë në raportet e tyre vlerat aktuale të treguesve të parapara nga metodologjinë për statistikën gjyqësore. Të anketuarit janë përgjigjur se sistemi Informativ gjyqësor (AKMIS) ka ose ka pjesërisht pesë lloje të të dhënave: 1) sa u përket të dhënave të nevojshme për të përgatitur raporte vjetore të gjykatave, të anketuarit më së shpeshti kanë konfirmuar që sistemi ka të dhëna të tilla (30%), 27% janë prononcuar se ka pjesërisht, dhe 23% janë përgjigjur negativisht; 2) për vjetërsinë e lëndëve nga 29% janë përgjigjur se sistemi ka të dhëna të tilla, përkatësisht se ka pjesërisht të dhëna, ndërsa 21% janë prononcuar se sistemi nuk ofron të dhëna të tilla; 3) për numrin e seancave të shtyra 32% e të anketuarve janë përgjigjur se sistemi informativ nuk ka të dhëna, 29% se ka pjesërisht dhe vetëm 21% kanë menduar se ka të dhëna të tilla; 4) në lidhje me vlerën e treguesve nga metodologjia për statistikën gjyqësore, 25% janë përgjigjur se sistemi ka të dhëna të pjesërisht, 22% që nuk ka të dhëna dhe 16% që ka; 5) për të dhëna të tjera që janë të rëndësishme për mbajtjen e statistikës për sistemin e drejtësisë, 15% kanë konfirmuar që sistemi informativ ka të dhëna, 26% që ka pjesërisht, dhe 10% që nuk ka. Qëndrimet e ndryshme të të anketuarve për këtë çështje mund të jenë si pasojë e njohjes së ndryshme të nëpunësve gjyqësorë me të dhënat e mbledhura nga sistemi, ndryshimeve ndërmjet nëpunësve në lidhje me parametrat që në praktikë i fusin rregullisht në të, si dhe dallimet në cilësinë e futjes ndërmjet nëpunësve të caktuar, gjë që mund të rezultojë me nevojën që të dhënat e mbledhura të kontrollohen pjesërisht ose plotësisht «manualisht» para se të përdoren për raportimin e performancave. d) Stafi i specializuar gjyqësor për monitorim dhe evaluim. Një pjesë e nëpunësve gjyqësorë në gjykatat dhe Këshillin gjyqësorë meren me përgatitjen e raporteve periodike për punën e gjykatave. dh) Anketat e realizuara ndërmjet shfrytëzuesve gjyqësorë dhe profesionistëve juridikë. Institucionet shtetërore realizojnë anketa të tilla, por këtë e bën periodikisht shoqëria civile. 	Analiza e sud.mk dhe Metodologjia e statistikës gjyqësore, Anketa e nëpunësve gjyqësorë

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
3.2. DREJTIMI STRATEGJIK: PËRFORCIMI I KAPACITETEVE PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN (DREJTIMI 2.5.3 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES P-R DREJTIMIT STRATEGJIK	3.2.1 Standardet për dhënie të informatave për rastet e palëve Rreth 46% e qytetarëve të anketuar janë të kënaqur me informatën e dhënë nga gjykata për datën, kohën dhe numrin e sallës së gjykimit për lëndën, dhe rreth 28% janë të pakënaqur dhe 18% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. 41% janë pjesërisht ose plotësisht të kënaqur me informatën në cilën fazë është procedura për lëndën e tyre, rreth 35% janë të pakënaqur, ndërsa 21% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. Sa i përket informacionit për shtyrjen e seancës, 38% e të anketuarve janë të kënaqur nga informata e marrë, 37% janë të pakënaqur nga ajo dhe 15% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. 44% e të anketuarve janë të kënaqur me arritshmërinë e dokumentacionit të gjykatës për lëndën e tyre, ndërsa 33% janë të pakënaqur nga arritshmëria, dhe 20% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.	Anketa e qytetarëve – pjesëmarrës në procedurat gjyqësore
TREGUES P-R DREJTIMIT STRATEGJIK	3.2.2 Hapja e procedurave për publikun dhe kapacitetet e sallave gjyqësore për të akomoduar publikun dhe mediat Në ndërtesën e re të Gjykatës Penale në Shkup – ku zhvillohen procedurat për të cilat zakonisht ka interesim më të madh në nivel kombëtar – kushtet për publikun janë përmirësuar, por shpesh mediat dhe publiku që janë të pranishëm në gjykimet nuk janë në gjendje t'i ndjekin ato për shkak të sistemit të zërit që është i shkyçur. Në raportin e monitorimit nga nëntori 2019, Koalicioni konstatoi se në seancën gjyqësore për lëndën "TORTURA" NRP. 1959/17, publiku dhe ekspert[u përjashtuan gjatë paraqitjes së një video, pa dhënë arsye të gjykata për këtë.	Bisedë me përfaqësues të Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë"; Brifing për Monitorimin – sektori i drejtësisë: procedurat aktuale gjyqësore, nëntor 2019
TREGUES P-R DREJTIMIT STRATEGJIK	3.2.3 Arritshmëria e trajnimeve për të punësuarit në gjykata për lloje të ndryshme të komunikimit Në vitin 2019, 62% e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të gjykatave (21 nga 34) kanë marrë pjesë në trajnimin e specializuar për marrëdhëniet me publikun (trajnim i specializuar për kryetarët e gjykatave), dhe 3% (14) e gjykatësve të mbetur kanë marrë pjesë në trajnimin e marrëdhënies me publikun.	Përgjigje nga AGJPP ndaj kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 ⁶²
TREGUES P-R DREJTIMIT STRATEGJIK	3.2.4 Numri i raporteve periodike të publikuara për shpenzimet e kategorizuara të gjykatave Dy raporte të publikuara vjetore: 1) Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor përmban një kapitull kushtuar shpenzimeve të pushtetit gjyqësor, të kategorizuara në: rroga dhe kompensime, mallra dhe shërbime, transferime dhe shpenzime kapitale; 2) Pasqyrë e shpenzimeve sipas këtyre kategorive është dhënë edhe në Raportin për realizimin e buxhetit gjyqësor, por në të është paraqitur edhe pasqyra e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, si dhe sipas zërave dhe nënzërave buxhetore. ⁶³	Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019; Raporti për realizimin e buxhetit gjyqësor për vitin 2019

62 Të dhënat e marra nga raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 janë në lidhje me numrin mesatar të gjykatësve, që në vitin 2019 është 512. Sipas raportit në fillim të vitit 2019 ka pasur 518 gjykates, ndërsa më 31 dhjetor 2019 ka pasur 506 gjykates.

63 Me përjashtim të kategorisë 40 – rroga dhe kompensime, ku janë cekur vetëm emrat e zërave, por nuk është precizuar sa janë shpenzimet për çdo zë të caktuar.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
3.3. DREJTIMI STRATEGJK: BARAZIMI I FORMËS SË RAPORTEVE VJETORE PËR PUNËN E GJYKATËSVE, PROKURORËVE PUBLIKË, KGJ DHE KPP (DREJTIMI 2.5.4 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">TREGUES PËR MASËN/AKTIVITETIN</p> <p>3.3.1 Progres në procesin e rishikimit të metodologjisë për statistikë gjyqësore</p>	<p>Nuk është publikuar metodologji e rishikuar për statistikë gjyqësore; gjatë shqyrtimit të raporteve të publikuara vjetore për punën e gjykatave, mund të vërehen ndryshime në strukturën e tyre, ndërsa ato nuk përmbajnë të dhëna për vlerën e treguesve të paraparë me metodologjinë (me përjashtim të treguesit për numrin e përgjithshëm të lëndëve të mbetura), si dhe për kohëzgjatjen e procedurave sipas llojeve të lëndëve civile, përkatësisht bazave për lëndët penale dhe periudhës së zgjidhjes, përkatësisht kohëzgjatjes së fazave të caktuara në procedurat, rezultatet dhe masat për lëndët penale. Këto konstatime janë të zbatueshme edhe për raportin vjetor për përjashtimet nëpër gjykata, si dhe për lëndët e zgjidhura përmes ndërmjetësimit në procedurat civile. Megjithatë, në raportin e KGJ jepet një pasqyrë mbi gjendjen e lëndëve të vjetra edhe në kategoritë e vjetërsisë së tyre.</p>	<p>Ueb faqja e Ministrisë së Drejtësisë; raporte vjetore për punën e gjykatave</p>

4. SFERA STRATEGJIKE: PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE KRIJIMI I POLITIKAVE

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
4.1. DREJTIMI STRATEGJIK: KOORDINIMI I REFORMËS NË SEKTORIN E DREJTËSISË (DREJTIMI 3.1.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	4.1.1 Ekzistimi e njësisë ose stafit funksional në Këshillin Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë për planifikim strategjik, monitorim dhe koordinim të reformës	Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë staf të mjaftueshëm për planifikimin strategjik, monitorim dhe koordinim të reformës.	Raporti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019: Bisedë në Ministrinë e Drejtësisë
	4.1.2 Ekzistimi e njësisë dhe stafit funksional në Këshillin Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë për analiza dhe kërkime	Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë staf të mjaftueshëm për analiza dhe hulumtime.	Raporti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019: Bisedë në Ministrinë e Drejtësisë
	4.1.3 Shpeshësia e konsultimeve për ndryshimet ligjore që ndikojnë drejtpërdrejt në sistemin e drejtësisë	Pjesa më e madhe gjykatësve (54%) dhe avokatëve (64%) janë përgjigjur se Qeveria vetëm ndonjëherë i konsulton kur bëhet fjalë për iniciimin e ndryshimeve ligjore që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sistemin e drejtësisë. Për dallim nga ajo, prokurorët më shpesh (48%) janë përgjigjur se janë konsultuar rrallë.	Anketë e gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë
	4.1.4 Kapaciteti për buxhetim efikas të gjykatësve dhe prokurorëve publikë	Kapaciteti për buxhetim efikas nga gjykatat, avokatët dhe prokurorët publikë më shpesh (30%) e kanë vlerësuar me 4 në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i mirë, dhe 26% kanë dhënë vlerësim mesatar 3. Vlerësime më të ulëta (1 dhe 2) kanë dhënë 28% të të anketuarve. Kapaciteti për buxhetim efikas nga prokuroritë publike, avokatët dhe prokurorët publik më shpesh (35%) e kanë vlerësuar atë me vlerësimin më të ulët 1, ndërsa 27% kanë dhënë vlerësim mesatar.	Anketë e avokatëve dhe prokurorëve publikë
	4.1.5 Ndryshimi në gjendjen me planifikimin strategjik dhe krijimin e politikave	Avokatët dhe nëpunësit gjyqësorë më shpesh janë përgjigjur se nga viti 2017 deri në vitin 2020 nuk ka ndryshim në gjendjen me planifikimin strategjik dhe krijimin e politikave në sektorin (përkatesisht 49% dhe 37%). Gjykatësit më shpesh kanë vlerësuar se gjendja është përmirësuar (48%), ndërsa megjithatë 44% kanë vlerësuar se nuk ka ndryshim.	Anketë e gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
4.2. DREJTIMI STRATEGJIK: MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË (DREJTIMI 3.1.4 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	4.2.1 Numri i debateve të zhvilluara me palët e interesuara mbi rezultatet e zbatimit të strategjisë	Në vitin 2019, u mbajtën katër seanca të Këshillit për zbatimin e strategjisë për reforma në sistemin e drejtësisë, ku përfaqësuesit e palëve të interesuara debatojnë për rezultatet e arritura dhe miratojnë rekomandime për zbatimin e ardhshëm të Strategjisë..
	4.2.2 Numri i rekomandimeve që dalin nga debatet për marrjen e masave korrigjuese	Janë identifikuar rekomandimet lidhur me gjashtë sfera.
		vlada.mk Informata nga seancat e Këshillit për realizimin e strategjisë për reforma në sistemin e drejtësisë; Raporti vjetor për vitin 2018 për realizimin e Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë 2017-2022

5. SFERA STRATEGJIKE: INSTITUCIONET E DREJTËSISË

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
5.1. DREJTIMI STRATEGJIK: OPTIMIZIMI I RRJETIT GJYQËSOR (DREJTIMI 4.1.1.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR MASAT/AKT/AKTIVITETET	5.1.1 Numri i debateve të zhvilluara për optimizimin e rrjetit gjyqësor	Analiza e rrjetit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë u prezantua në seancën e dhjetë të Këshillit për monitorimin e zbatimit të strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë, e cila u mbajt më 6 shkurt 2019.	Fqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë ⁶⁴
	5.1.2 Numri i implementimit të rekomandimeve për optimizimin e rrjetit gjyqësor	Në dhjetor 2018, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, u bë "Analizë e rrjetit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë". ⁶⁵ Në drejtim të racionalizimit të gjykatave, siç është cekur edhe në analizën, nevojitet një analizë më të detajuar për secilën gjykatë individualisht, gjë që deri më tani nuk është bërë. Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat nga viti 2019, ⁶⁶ e në bazë të kësaj analize, Gjykata Themelore në Gjevgjeli, Gjykata Themelore në Kavadarçë dhe Gjykata Themelore në Kërçovë nga viti 2020 janë gjykata me kompetencë të zgjeruar. Në drejtim të përcaktimit të numrit real të nevojës të gjykatësve dhe gjykatave, përveç Analizës së përgatitur të rrjetit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë (për gjykatat themelore), janë përgatitur edhe analizë funksionale e gjykatave të apelit dhe analizë funksionale e Gjykatës Supreme të RMV.	Raporti në hije për Kapitullin 23 për periudhën prill 2019 - mars 2020; ⁶⁷ Analiza e rrjetit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë ⁶⁸

64 <https://www.pravda.gov.mk/vest/2941>.

65 Karamandi, Popçevski dhe Naumovb, „Analiza e rrjetit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë“.

66 „Gazeta zyrtare“, nr. 96/2019, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

67 Raporti është i arritshëm në: <https://epi.org.mk/post/14897>.

68 I arritshëm në: https://www.pravda.gov.mk/Upload/Editor_Upload//%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D1%81%D1%83%D0%B4%D1%81%D0%BA%D0%B0%20%D0%B-%D1%80%D0%B5%D0%B6%D0%B0.pdf

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
5.2. DREJTIMI STRATEGJIK: BUXHETI I PAVARUR DHE I QËNDRUESHËM, KONSISTENT ME PËRCAKTMIN LIGJOR NGA TË ARDHURAT BRUTO KOMBËTARE⁶⁹ (DREJTIMI 2.1.6 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	5.2.1 Shpenzimet për gjykatat	0.29% e PBV-së në 2019, që është një rritje në krahasim me vitin 2018, kur ka qenë 0.28% e PBV-së. E llogaritur për banorë, shënohet rritje në 990 denarë për banorë, krahasuar me 885 denarë për banorë në vitin 2018.	Ministria e Financave -tregues makroekonomikë themelorë; Raporti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 dhe për vitin 2018
	5.2.2 Kriteret për përcaktimin e buxhetit gjyqësor	Megjithëse ekziston një këshill i pavarur buxhetor gjyqësor, gjyqësori ende nuk arrin të realizojë nivelin e nevojshëm të financimit. Si ilustrim mund të thuhet se në vitin 2019 buxheti i aprovuar përfundimisht i pushtetit gjyqësor është vetëm 66% e kërkesës që është bazuar në nevojat reale të njëjësive-përdorues të pushtetit gjyqësor.	Raporti për realizimin e buxhetit gjyqësor për vitin 2019.
	5.2.3 Struktura e buxhetit gjyqësor	Vërehet pjesëmarrje dominuese prej 72% në kategorinë 40 - rroga dhe kompensime, ndërsa vërehet ulje krahasuar me vitin 2018, kur kjo kategori ka qenë pothuajse 80%. Kategoria 42 - mallra dhe shërbime, që në buxhetin e përgjithshëm merr pjesë me 12.76%, është e pamjaftueshme për të pastruar të gjitha nevojat që dalin nga puna e rregullt e gjykatave. Krahasuar me strukturën e buxhetit të vendeve të Bashkimit Evropian, pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale (7.25%), ku janë përfshirë edhe investime në modernizimin kompjuterik dhe softuerik, nuk është në nivelin e duhur. Megjithatë, vërehet rritje të pjesëmarrjes së kësaj kategorie në krahasim me vitin 2018, kur ajo ka qenë vetëm 4.07%. Transfertat janë 7.76%.	Raporti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2019 edhe për vitin 2018
	5.2.4 Përqindja e mbulimit të shpenzimeve reale për zbatimin e drejtësisë nga buxhetet gjyqësore vjetore	Në vitin 2019, buxheti i aprovuar përfundimisht i pushtetit gjyqësor është vetëm 66% e kërkesës që është bazuar në nevojat reale të njëjësive-shfrytëzues të pushtetit gjyqësor. Ky është një përmirësim krahasuar me vitin 2018, kur ky mbulim ka qenë 64%.	Raporti për realizimin e buxhetit gjyqësor për vitin 2019
Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
5.3. DREJTIMI STRATEGJIK: RITJIA E KUADRIT NË SHËRBIMIN E PROKURORISË PUBLIKE (DREJTIMI 4.1.3.6 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
5.3.1 Shkalla e produktivitetit	104 Kallëzime të zgjidhura penale për prokuror në vitin 2018.	Raport i Prokurorisë Publike	

69 Në strategjinë, ky drejtim strategjik paraqitet nën qëllimin strategjik "pavarësia dhe paanshmëria", por në këtë raport është zhvendosur nën kapitullin për institucionet e drejtësisë, sepse shqyrtohet në aspekt të resurseve në sektorin e drejtësisë.

6. SFERA STRATEGJIKE: SFERA NDËSHKIMORE-JURIDIKE

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
6.1. DREJTIMI STRATEGJIK: VEPRIMI I DREJTË ME PËRFORCIMIN E TË DREJTAVE TË MBROJTJES DHE DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË PROCEDURËN PENALE (DREJTIM 5.1.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	6.1.1 Kënaqësia e palëve në lidhje me mundësinë e dhënë nga gjykata secilës palë për të prezantuar dëshmitë e tyre dhe për të kundërshtuar dëshmitë e palës së kundërt	Rreth 98% e qytetarëve të anketuar (pjesëmarrës në procedurë penale) besojnë se është e rëndësishme që secila palë të ketë mundësinë të paraqesë dëshmitë e saj për lëndët dhe t'i kontestojë ato të palës tjetër. 41% e të anketuarve janë relativisht të kënaqur (kanë dhënë vlerësim 5 ose 4) nga mundësia për të prezantuar dhe kontestuar dëshmitë që kanë, ndërsa 32% janë relativisht të pakënaqur (kanë dhënë vlerësim 1 - më të pakënaqur ose 2).	Anketë me qytetarët ⁷⁰
	6.1.2 Perceptimi i palëve për atë se sa gjykatësit dhe prokurorët i respektojnë të drejtat e të akuzuarve dhe viktimave	Rreth 90% e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht se prokurorët dhe gjykatësit i respektojnë të drejtat e të akuzuarve dhe tëtë dëmtuarve në procedurat, kundrejt atyre rreth 10% që nuk pajtohen.	Anketa me avokatët dhe prokurorët publikë
	6.1.3 Perceptimi i palëve për atë nëse gjykatat i trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë dhe të paanshme pavarësisht nga të ardhurat, përkatësia etnike, prejardhja shoqërore, gjinia dhe religjioni	58% e qytetarëve të anketuar pajtohen plotësisht ose pjesërisht se gjykatësit i trajtonin njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht nga të ardhurat, origjina, gjinia dhe religjioni, dhe 41% nuk pajtohen me këtë. 60% e qytetarëve të anketuar pajtohen se stafi i gjykatës trajton njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht nga të ardhurat, origjina, gjinia dhe religjioni, dhe 40% nuk pajtohen	Anketë me qytetarët
	6.1.4 Perceptimet e palëve nëse gratë viktime të dhunës seksuale dhe dhunës tjetër me bazë gjinore trajtohen në mënyrë të drejtë nga gjykata	Lidhur me të drejtat e pjesëmarrësve në procedurën, hulumtuam se sa respektohen ata në lëndët për dhunën seksuale dhe dhunën tjetër me bazë gjinore. Rreth 53% e avokatëve dhe prokurorëve kanë punuar në lëndë të tilla. Të anketuarit që kanë punuar në lëndë të tilla u pyetën më tej nëse bien dakord që gratë viktime të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore të trajtohen në mënyrë të drejtë në procedurën. Pjesa më e madhe e tyre, 62%, pajtohen plotësisht që gratë janë trajtuar në mënyrë të drejtë në procedurë. 38% pajtohen pjesërisht.	Anketë me avokatët dhe prokurorët publikë
	6.1.5 Perceptimi i palëve për respektimin e prezumimit të pafajësisë	40% e qytetarëve të anketuar janë plotësisht ose pjesërisht të kënaqur me respektimin e prezumimit të pafajësisë nga gjykata, dhe 36% janë të pakënaqur, ndërsa 14% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. 30% e qytetarëve të anketuar janë të kënaqur me respektimin e prezumimit të pafajësisë nga Prokuroria Publike, dhe 39% janë të pakënaqur, ndërsa 8% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. 19% e qytetarëve të anketuar janë të kënaqur me respektimin e prezumimit të pafajësisë nga mediat, dhe 50% janë të pakënaqur, ndërsa 10% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.	Anketë me qytetarë

70 Në lidhje me këtë tregues u veçuan përgjigjet e qytetarëve që marrin pjesë në procedura penale si palë në procedurën.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
6.1. DREJTIMI STRATEGJIK: VEPRIMI I DREJTË ME PËRFORCIMIN E TË DREJTAVE TË MBROJTJES DHE DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË PROCEDURËN PENALE (DREJTIM 5.1.2 NË STRATEGJINË PËR REFORMË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK 6.1.6 Perceptimi për atë nëse gjykatësit janë të lirë të marrin vendime pa ndërhyrje direkte ose indirekte nga Qeveria ose politikanët	Shumica e avokatëve dhe prokurorëve publikë (47%) konsiderojnë se pushteti ekzekutiv shpesh u përzihet gjykatësve në vendimet gjyqësore, dhe 34% kanë theksuar se edhe deputetët shpesh bëjnë të njëjtën gjë. Në pjesën më të madhe gjykatësit kanë cekur se nuk përballen me ndërhyrje në vendimmarrje, dhe atë nga kryetari i gjykatës (ku 93% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo nuk ndodh asnjëherë ose rrallë), organizatat e shoqërisë civile (ku 83% e të anketuarve janë përgjigjur që kjo ndodh asnjëherë ose rrallë), përfaqësuesit e vendeve të tjera (ku 80% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo nuk ndodh asnjëherë ose rrallë) dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare (ku 81% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk ndodh asnjëherë ose rrallë). Lidhur me faktorët tjerë që përipiqen të ndikojnë mbi vendimet, 86% janë përgjigjur se ekzistojnë të tilla.	Anketa me avokatë, prokurorë publikë dhe gjykatës
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK 6.1.7 Numri i trajnimeve të planifikuara për gjykatësit dhe prokurorët publikë të përqëndruar në forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurat penale	Numri i trajnimeve të planifikuara në vitin 2019 për gjykatësit dhe prokurorët publikë të përqëndruar në forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurat penale është 9.	Përgjigje nga AGJPP ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK 6.1.8 Numri i trajnimeve të realizuara për gjykatës dhe prokurorë publikë të përqëndruar në forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurën penal	Numri i trajnimeve të realizuara në vitin 2019 për gjykatës dhe prokurorë publikë të përqëndruar në forcimin e të drejtave të mbrojtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në procedurat penale është 8.	Përgjigje nga AGJPP ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
6.2. DREJTIMI STRATEGJIK: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT PËR DREJTËSINË E FËMIJËVE (DREJTIM 5.1.5 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
6.2.1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 14 deri 18 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se një vit	Përfundimisht me muajin shkurt 2020, tre fëmijë të moshës 14 deri 18 vjeç të cilët vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se një vit në shtëpinë edukuese-korrigjuese në Tetovë	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
6.2.2 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 14 deri 18 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se tre vite	Përfundimisht me muajin shkurt 2020, tre fëmijë të moshës 14 deri 18 vjeç të cilët vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se tre vite në shtëpinë edukuese-korrigjuese në Tetovë	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
6.2.3 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 18 deri 23 vjeç që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se tre vite	Kërkesës dërguar DES, në të cilën është cekur "Numri i përgjithshëm i të rinjve të moshës 18 deri 23 vjeç të cilët vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese për më shumë se tre vite", ⁷¹ iu është përgjigjur se gjithsej tre fëmijëve të moshës 14 deri në 23 vjeç janë duke vuajtur masë në Shtëpinë edukuese-korrigjuese Tetovë për më shumë se tre vite	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
6.2.4 Numri i përgjithshëm i fëmijëve viktime të veprave penale që kanë marrë ndihmë juridike falas gjatë vitit	Në vitin 2018 dhe 2019, në Ministrinë e Drejtësisë nuk u dërgua asnjë kërkesë për miratimin e ndihmës juridike falas për fëmijët viktime të veprave penale	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Ministria e Drejtësisë
6.2.5 Numri dhe profili i ndjekësve të trajnimit të vazhdueshëm në AGJPP të cilët kanë kaluar trajnime për trajtimin e fëmijëve viktime	Në vitin 2019, trajnim të tillë në AGJPP kanë kaluar 8 gjykatës, 12 prokurorë publik, 2 bashkëpunëtorë ekspertësh nga gjykatat dhe prokuroritë dhe 15 përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në vitin 2018, trajnim të tillë kanë kaluar 44 gjykatës, 40 prokurorë publikë, 26 bashkëpunëtorë ekspertësh nga gjykatat dhe prokuroritë, 13 avokatë dhe 2 ndjekës të trajnimit fillestar.	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Akademia e Gjykatave dhe Prokurorëve Publikë
6.2.6 Numri i trajnimeve të mbajtura në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm në AGJPP që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve viktime	Në vitin 2019 janë organizuar dy këshillime. Në vitin 2018 janë organizuar shtatë evenimente, nga të cilat gjashtë këshillime dhe një trajnim për trajnuesit.	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik nga Akademia e Gjykatave dhe Prokurorëve Publikë

71 Në pajtim me nenin 46 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, "Fëmija qëndron në shtëpinë edukuese-korrigjuese për të paktën një vit, e më së shumti pesë vite, përkatësisht deri sa të bëhet 23 vjeç. "Gjatë shqiptimit të kësaj mase, gjykata nuk përcakton kohëzgjatjen e saj, por për atë vendos në mënyrë plotësuese." Për shkak të kësaj, ne donim të shihnim se sa prej personave që vuajnë masë institucionale në shtëpinë edukuese-korrigjuese hyjnë në kategorinë e të rinjve.

7. SFERA STRATEGJIKE: SFERA JURIDIKE DHE E KUNDËRVAJTJES

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
7.1. DREJTIMI STRATEGJIK: PARANDALIMI KUNDREJT REPRESIONIT SI QËLLIM KRYESOR I PROCEDURËS PËR KUNDËRVAJTJE (DREJTIMI 5.3.4 NË STRATEGJINË PËR REFORMË NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK		
7.1.1 Pjesëmarrja e masave parandaluese (vendim, edukim) kundrejt masave represive (gjobë, barazim, kallëzim për kundërvajtje) në numrin e përgjithshëm të masave të shqiptuara pas mbikëqyrjes inspektuese	Masat parandaluese (vendimi, edukimi) mbizotërojnë bindshëm kundrejt masave represive (gjobë, barazim, kallëzim për kundërvajtje) në numrin e përgjithshëm të masave të shqiptuara pas mbikëqyrjes inspektuese me 85%.	Raportet tremujore të Këshillit për Mbikëqyrje Inspektuese për vitin 2019 (tre tremujorët e parë)
7.1.2 Përqindja e lëndëve me procedurën e ngritur e barazimit kundrejt përqindjes së lëndëve për të cilat është ngritur kallëzim për kundërvajtje	Procedura e barazimit zbatohet më shpesh (64%) kundrejt ngritjes së kallëzimit për kundërvajtje.	Raportet tremujore të Këshillit për Mbikëqyrje Inspektuese për vitin 2019 (tre tremujorët e parë)

8. SFERA STRATEGJIKE: SFERA CIVILE-JURIDIKE

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi	
8.1. DREJTIMI STRATEGJIK: VENDOSJA E SISTEMIT TË QËNDRUESHËM CIVIL-JURIDIK PËRMES PLOTËSIMIT TË VAKUMEVE TË PËRHERSHME JURIDIKE DHE HARMONIZIMIT ME STANDARDET EVROPIANE DHE RRJEDHAT SHOQËRORE BASHKËKOHORE (DREJTIMI 5.4.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMË SEKTORIN E DREJTËSISË)			
TREGUES PËR DREJTIMIN STRATEGJIK	8.1.1 Perceptimi i palëve nëse gjykatat i trajtojnë njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht nga të ardhurat, origjina kombëtare ose shoqërore, gjinia apo religjioni	Shumica e qytetarëve të anketuar pajtohen plotësisht ose pjesërisht se gjykatësit dhe stafi gjyqësor i kanë trajtuar njerëzit në mënyrë të barabartë pavarësisht nga të ardhurat e tyre, origjina kombëtare ose shoqërore, gjinia apo religjioni. Rreth një e treta e qytetarëve nuk mendojnë se ka trajtim të barabartë. Avokatët plotësisht ose pjesërisht pajtohen se gjykatësit dhe stafi gjyqësor nuk bëjnë diskriminim. Megjithatë, pothuajse 13% nuk mendojnë se ka trajtim të barabartë.	Anketa e qytetarëve-palëve në procedurë dhe avokatëve
	8.1.2 Kënaqshmëria e palëve nga mundësia për t'i paraqitur dëshmitë e tyre para gjykatës dhe për t'ia kundërshtuar ato palës tjetër	59% e qytetarëve të anketuar kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën se si u është mundësuar paraqitja e dëshmimeve, 14% kanë qenë relativisht të pakënaqur dhe 23% nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. 63% e avokatëve të anketuar kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën u është mundësuar të paraqesin dëshmi, dhe 38% nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.	Anketa e qytetarëve-pjesëmarrës në procedura gjyqësore dhe avokatëve
	8.1.3 Kënaqshmëria e palëve nga ajo se si gjykata i ka dëgjuar dëshmitarët	53% e qytetarëve të anketuar kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën se si gjykatësi i ka dëgjuar palët, 16% kanë qenë relativisht të pakënaqur dhe 18% nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur. Gjysma e avokatëve kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën se si gjykatësi i ka dëgjuar palët, dhe gjysma tjetër nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.	Anketa e qytetarëve-pjesëmarrës në procedura gjyqësore dhe avokatëve
	8.1.4 Kënaqshmëria e palëve nga kohëzgjatja e procedurës	45% e qytetarëve të anketuar që kanë marrë pjesë në procedurë gjyqësore civile nuk janë të kënaqur me kohëzgjatjen e saj. Arsyeja kryesore e pakënaqësisë me kohëzgjatjen e procedurës në mesin e atyre qytetarëve që shprehën pakënaqësi janë periudhat e gjata kohore midis seancave të caktuara. Qytetarët gjithashtu janë të pakënaqur me shtyrjen e shpeshtë të seancave. Pjesa më e madhe e avokatëve të anketuar (44%) e kanë vlerësuar me 3 kënaqshmërinë e tyre nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shkallë nga 1 në 5. Deri në 63% të të anketuarve kanë pasur tre deri në pesë shtyrje (prolongime), përkatësisht seanca që nuk janë mbajtur për lëndën e fundit civile për të cilën ata janë paraqitur në gjykatën themelore. 12% e të anketuarve kanë pasur më shumë se pesë shtyrje ose mosmbajtje të seancave gjyqësore. Vetëm 6% e avokatëve dhe prokurorëve të anketuar nuk kanë pasur asnjë shtyrje. Avokatët u pyetën gjithashtu edhe për arsytet më të shpeshta të shtyrjes së procedurave gjyqësore. Tri arsytet kryesore që shpesh ose herë pas here çojnë në shtyrje të procedurave civile janë dobësitë në ligjet (88%), ⁷⁵ kthimi i lëndëve në vendimmarrje të sërishme në gjykatën themelore (75%) dheobstruksionet nga të huajt në procedurë (56%). ⁷⁶	Anketa e qytetarëve-pjesëmarrës në procedura gjyqësore dhe avokatëve

75 Për shembull, kundërthënie në ligjet, pasaktësi, interpretime të ndryshme të ligjeve.

76 Për shembull, mosardhje të qëllimshme të dëshmitarëve dhe palëve tjera, shyrje e qëllimshme nga ana e avokatëve.

Tregues	Vlera në vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018, nëse ka të dhëna	Burimi
8.1. DREJTIMI STRATEGJIK: VENDOSJA E SISTEMIT TË QËNDRUESHËM CIVIL-JURIDIK PËRMES PLOTËSIMIT TË VAKUMEVE TË PËRHERSHME JURIDIKE DHE HARMONIZIMIT ME STANDARDET EVROPIANE DHE RRJEDHAT SHOQËRORE BASHKËKOHORE (DREJTIMI 5.4.1 NË STRATEGJINË PËR REFORMA NË SEKTORIN E DREJTËSISË)		
TREGUES PËR DEJTIMIN STRATEGJIK	<p>8.1.5 Numri i gjykatave në faqet e internetit të të cilave janë shfaqur qartë të dhënat për shpenzimet e nevojshme për udhëheqjen e procedurave⁷⁷</p> <p>Gjykata Supreme dhe gjykatat e apelit nuk kanë publikuar të dhëna të tilla.</p> <p>Lidhur me shpenzimet për vërtetime, certifikata ose verifikime të ndryshme: 13 gjykatat themelore kanë publikuar shpenzime dhe të dhëna për llogaritë e pagueshme;⁷⁸ një ka publikuar shpenzimet, por ka informatë mbi llogaritë e pagueshme vetëm për certifikatat nga evidenca ndëshkimore;⁷⁹ pesë kanë publikuar edhe llogari të pagueshme për një pjesë të certifikatave;⁸⁰ dhe tre kanë publikuar vetëm llogari të pagueshme, por pa informata mbi shpenzimin.⁸¹ Pesë gjykatat themelore nuk kanë publikuar asnjë informatë mbi këto shpenzime.⁸²</p> <p>Në lidhje me shpenzimet për proceduras tjera dhe paushalle: dy gjykata themelore kanë publikuar shpenzime dhe të dhëna për fletëpagesa;⁸³ një ka publikuar vetëm informata për shpenzimet, por jo edhe llogaritë e pagueshme;⁸⁴ tetë kanë publikuar vetëm llogari të pagueshme, por jo edhe informata për shpenzimet;⁸⁵ një ka publikuar të dhëna vetëm për procedurën e trashëgimisë;⁸⁶ 15 gjykata themelore nuk kanë publikuar kurrfarë informata.⁸⁷</p>	<p>Analiza e materialit të publikuar në ueb faqet</p>

77 Si paraqitje e pranueshme e të dhënave konsiderohet edhe paraqitja e Ligjit për taksat gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës ose ekstrakt nga ai.

78 Veles, Vinicë, Dellçevë, Gostivar, Gjykata Themelore Penale në Shkup, Kavadar, Kërçovë, Koçan, Kratovë, Kumanovë, Negotinë, Shën Nikollë, Strugë.

79 Gjykata themelore Ohër.

80 Gjykatat themelore në Manastir, dibër, Krishevë, Prilep dhe Tetovë.

81 Gjykatat themelore në Kriva Pallankë, Strumicë dhe Shtip.

82 Gjykatat themelore në Berovë, gjevgjeli, Gjykata Themelore Civile në Shkup, Resnjë dhe Radovish.

83 Gjykata themelore në Vinicë dhe Gjykata Themelore Penale në Shkup.

84 Gjykata themelore në Ohër.

85 Gjykatat themelore në Veles, Gostivar, Kavadar, Kratovë, Kriva Pallankë, Negotinë, Strumicë dhe Shtip.

86 Gjykata themelore në Shën Nikollë.

87 Gjykatat themelore bo Berovë, Manastir, Dellçevë, Gjevgjeli, Kërçovë, Koçan, Krushevë, Kumanovë, Prilep, Radovish, Resnjë, Strugë, Tetovë, Shkup.



***KONSTATIME
PËRFUNDIMTAR***



1. QËLLIMI STRATEGJIK: CILËSIA

- Rezultatet nga anketa e realizuar tregojnë se perceptimi për kompetencën e gjyqtarëve dhe prokurorëve është në nivel të kënaqshëm, përkatësisht kompetenca e gjykatësve dhe prokurorëve është vlerësuar me 4, në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë.
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë organizon trajnime vazhdimisht në kuadër të programit për trajnim të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat. Është pozitive ajo që gjatë vitit 2019 është rritur numri i gjykatësve dhe prokurorëve publikë që kanë kaluar trajnim për praktikën gjyqësore të GJEDNJ, si dhe të cilët kanë kaluar trajnim për të drejtën e BE-së.
- Është bërë përmirësim i dukshëm me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor, të cilat janë vlerësuar pozitivisht edhe nga Komisioni i Venecias.
- Shërbimi i provës ka filluar aktivisht me punë që nga viti 2019. Ligji për shërbimin e provës është me rëndësi të jashtëzakonshme për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prandaj, rekomandohet trajnim intensiv i gjykatësve për zbatimin e Ligjit për shërbimin e provës, sepse bashkëpunimi me shërbimin e provës siguron qasje të drejtë për individualizimin e dënimit për çdo të akuzuar.⁸⁸
- Lidhur me drejtimin strategjik «Monitorimi i vazhdueshëm i efekteve të ekzekutimit dhe cilësisë së punës» ekziston ulje të shkallës së realizimit të dokumenteve ekzekutive në vitin 2019 për rreth 11% krahasuar me vitin 2018. Nevojiten analiza shtesë për të konstatuar nëse kjo ulje është për shkak të uljes së tarifës së përmbaruesve.
- Me Ligjin e ri për ndërmjetësim («Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë», Nr. 188/2013, 148/2015, 192/2015 dhe 55/2016), koncepti i ndërmjetësit është përmirësuar dukshëm. Me ndryshimet në Ligjin për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 124/2015) u fut përpjekje e detyrueshme për ndërmjetësim në kontestet ekonomike për kërkesën monetare vlere të cilave nuk tejkalojnë 1.000.000 denarë. Në periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2019, shkalla e suksesit të ndërmjetësit është 72% - nga gjithsej 1,570 lëndë, u arrit marrëveshje në 1,137 konteste. Shkalla e suksesit të kontesteve ekonomike të zgjidhura përmes ndërmjetësit është 28.3% (nga gjithsej 567 lëndë, marrëveshje u arrit në 161), ndërsa në kontestet e punës të zgjidhura përmes ndërmjetësit është 99.6% (nga gjithsej 948 lëndë, marrëveshje u arrit në 945 lëndë). Për kontestet e punës ku ndërmjetësimi ka shkallë të lartë suksesi, përkatësisht numër të madh të marrëveshjeve të arritura, është më e përshtatshme të futet ndërmjetësimi si një përpjekje e detyrueshme për këtë lloj të kontesteve. Nevojiten përpjekje shtesë për të përdorur ndërmjetësimin si një mënyrë alternative për zgjidhjen e kontesteve, në përputhje me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve, si dhe në kontestet e konsumatorëve.

⁸⁸ Conevska and Kamberi (n 9).

2. QËLLIMI STRATEGJIK: EFIKASITETI

- Vërehen rezultate solide në uljen e numrit të lëndëve të vjetra me 27% krahasuar me vitin 2018, si dhe në uljen për pothuajse 14% të numrit të lëndëve në të cilat është konstatuar shkelje e parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm. Megjithatë, nevojiten masa të përforcuara për ballafaqim më efikase me lëndët e pazgjidhura, të cilat shënojnë rritje prej pothuajse 9% për shkak të rritjes së fluksit të lëndëve të reja në vitin 2019.
- Gjykata e apelit më pak efikas shpenzon, mesatarisht, 33% më shumë për lëndë të zgjidhur sesa gjykata e apelit me efikasitet më të lartë në shpenzim. Mesatarisht, për një lëndë të zgjidhur te gjykata themelore në rangun e fundit shpenzohet 2.6 herë më shumë se gjykata themelore me efikasitet më të lartë në shpenzim. Shkalla e produktivitetit në zgjidhjen e lëndëve (numri i lëndëve të zgjidhura për gjykatës) tregon përmirësim në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 në 16 gjykata themelore dhe dy gjykata të apelit, ndërsa ulje te 11 gjykata themelore dhe dy gjykata të apelit. Nevojitet analizë e mëtejshme për të përcaktuar shkaqet për këto ndryshime të rëndësishme në efikasitetin dhe produktivitetin e gjykatave.
- Megjithëse Metodologjia e statistikës gjyqësore është pjesërisht e harmonizuar me treguesit relevantë të pranuar ndërkombëtarisht për gjyqësorin, ajo nuk zbatohet në praktikë. Nevojitet harmonizim shtesë e Metodologjisë dhe të publikohen vlerat aktuale të treguesve të përcaktuar me të në raportet e rregullta të pushtetit gjyqësor, e veçanërisht përpjekjet e orientuara për zbatimin e Metodologjisë në praktikë.
- Efikasiteti i gjykatave kryesisht varet edhe nga bashkëpunëtorët profesionalë gjyqësorë. Në vitin 2019, ka një rritje të vogël të numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë gjyqësorë në 1,22.89. Profesionalizmin dhe kompetencën e bashkëpunëtorëve profesionalë gjyqësorë të anketuar më së shpeshti e kanë vlerësuar me 4 (46%) në shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 është vlerësimi më i lartë. Atë vlerësim më shpesh e kanë dhënë avokatët dhe prokurorët publikë të anketuar (35%), por ata gjithashtu kanë një numër të konsiderueshëm të përgjigjeve me vlerësim 3 (34%). Kjo tregon se ka hapësirë për të investuar më tej në arsimimin e bashkëpunëtorëve profesionalë gjyqësorë.

3. QËLLIME STRATEGJIKE: TRANSPARENCA

- Gjykata Supreme dhe gjykatat e apelit publikojnë rregullisht raporte vjetore. Nga 27 gjykata themelore, vetëm tetë kanë publikuar raport vjetor për punën për vitin 2019, një ka publikuar analizë për punën për lëndët, katër kanë publikuar vetëm statistikë vjetore për lëndët, pesë kanë publikuar statistikë mujore për lëndët, që nuk është përmbledhur në nivel vjetor, ndërsa nëntë nuk kanë publikuar asnjë raport për punën. Ka dallime në formatin e raporteve vjetore të publikuara nga gjykatat. Nevojitet të sigurohet publikim i rregullt i raporteve vjetore për të gjitha gjykatat, në format të unifikuar dhe me publikimin e vlerave aktuale të treguesve të përcaktuara në Metodologjinë e statistikës gjyqësore.
- Në vitin 2019, 21 gjykatës morën pjesë në trajnime të specializuara për kryetarë të gjykatave për marrëdhënie me publikun, që është 62% e numrit të kryetarëve të gjykatave. 14 gjykatës tjerë morën pjesë në trajnim për marrëdhënie me publikun, që është 3% e numrit të gjykatësve të mbetur.⁹⁰

89 Nga 1,16 në 2018.

90 Është marrë parasysh numri mesatar i gjykatësve në vitin 2019 (512), gjë që është zvogëluar numri i përgjithshëm i kryetarëve të gjykatësve (34).

4. SFERA STRATEGJIKE: PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE KRIJIMI I POLITIKAVE

- Pjesa më e madhe e gjykatësve (54%) dhe avokatëve (64%) janë përgjigjur se Qeveria ndonjëherë i konsulton kur bëhet fjalë për iniciimin e ndryshimeve ligjore që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sektorin e drejtësisë. Për dallim nga ajo, prokurorët më shpesh (48%) janë përgjigjur se janë konsultuar rrallë. Nevojitet përfshirje më aktive dhe më gjithëpërfshirëse të përfaqësuesve të gjykatësve, avokatëve dhe prokurorëve publikë në krijimin e rregullave ligjore që zbatohen në gjyqësor, përfshirë edhe përmes shoqatave dhe dhomave të tyre.
- Kapaciteti për buxhetim efikas nga gjykatat, avokatët dhe prokurorët publikë më shpesh (30%) e kanë vlerësuar atë me 4 nga 5 të mundshëm, ndërsa 26% dhanë vlerësim mesatar prej 3. Kapaciteti për buxhetim efikas nga prokuroritë publike, avokatët dhe prokurorët publikë më shpesh (35%) e kanë vlerësuar atë me vlerësimin më të dobët 1, dhe 27% kanë dhënë vlerësim mesatar 3.
- Avokatët e anketuar dhe nëpunësit gjyqësor më shpesh janë përgjigjur se nga viti 2017 deri në vitin 2020 nuk ka asnjë ndryshim në gjendjen me planifikimin strategjik dhe krijimin e politikave në sektor (përkatësisht 49% dhe 37%). Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë staf të mjaftueshëm për analiza dhe hulumtime, planifikim strategjik, monitorim dhe koordinim të reformës. Nevojitet të forcohen kapacitetet për planifikim strategjik dhe krijim të politikave, përfshirë buxhetimin në organet e drejtësisë, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

5. SFERA STRATEGJIKE: INSTITUCIONET E DREJTËSISË

- Megjithëse buxheti i gjykatës është rritur në 0.29% të PBV-së në vitin 2019, nga 0.28% e PBV-së në vitin 2018, buxheti i aprovuar përfundimisht i buxhetit gjyqësor vetëm 66% nga niveli i kërkuar dhe nivelit i garantuar me ligj prej 0.8% e PBV-së. Duhet të merren masa urgjente për të ndaluar shkeljen e vazhdueshme të dispozitave ligjore.
- Megjithëse ekziston këshill i pavarur buxhetor gjyqësor, gjyqësori ende nuk arrin të arrijë nivelin e duhur të financimit. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve që në buxhetin e përgjithshëm merr pjesë me më pak se 13% është e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat që dalin nga puna e rregullt e gjykatave. Krahasuar me strukturën e buxhetit të vendeve të Bashkimit Evropian, pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale (7%), ku janë përfshirë edhe investimet në modernizimin kompjuterik dhe softuerik, nuk është në nivelin e duhur.

6. SFERA STRATEGJIKE: SFERA NDËSHKIMORE-JURIDIKE

- Barazia e armëve është një komponent thelbësor i së drejtës së gjyqimit të drejtë. Shumica e qytetarëve të anketuar-pjesëmarrës në procedurë janë të kënaqur (kanë dhënë vlerësim 5 ose 4) nga mundësia që u është dhënë nga gjykata për të paraqitur dhe kontestuar dëshmitë. Sidoqoftë, nuk është e papërfillshme përqindja e të anketuarve (32%) që janë të pakënaqur (kanë dhënë vlerësim 1 - më të pakënaqur ose 2) nga mundësia e dhënë për të paraqitur dhe kontestuar dëshmitë. Sa i përket respektimit të prezumimit të pafajësisë, rezultatet nga anketa tregojnë se ekziston pakënaqësi më e madhe (50%) te qytetarët qytetarëve në lidhje me respektimin e prezumimit të pafajësisë nga mediat.
- Megjithëse në vitin 2019, u miratua ligj i ri për ndihmën juridike falas, me të cilin zgjerohet rrethi i personave që mund të kërkojnë ndihmë të tillë, megjithatë në vitin 2018 dhe 2019 në Ministrinë e Drejtësisë nuk janë dorëzuar kërkesa për miratimin e ndihmës juridike falas për fëmijët viktime të veprave penale. Kjo tregon nevojën për të filluar menjëherë analizë të arsyeve për qëllimet dhe mënyrat e zbatimit të Ligjit të ri.

7. SFERA STRATEGJIKE: SFERA JURIDIKE DHE E KUNDËRVAJTJES

- Masat parandaluese (vendimi, edukimi) mbizotërojnë bindshëm kundrejt masave represive (gjobë, barazim, kallëzim për kundërvajtje) në numrin e përgjithshëm të masave të shqiptuara pas mbikëqyrjes inspektuese me 85%. Procedura e barazimit aplikohet më shpesh (64%) kundrejt ngritjes së kallëzimit për kundërvajtje.

8. SFERA STRATEGJIKE: SFERA CIVILE-JURIDIKE

- Rreth një e treta e qytetarëve dhe 13% e avokatëve nuk konsiderojnë se ekziston trajtim i barabartë nga gjykatat pavarësisht nga të ardhurat, origjina kombëtare ose shoqërore, gjinia apo religjioni. Megjithëse shumica e qytetarëve dhe avokatëve konsiderojnë se ka trajtim të barabartë, përqindja e atyre që nuk e konsiderojnë atë tregon nevojën për analizë të mëtejshme të arsyeve për këtë perceptim.
- 59% e qytetarëve të anketuar dhe 63% e avokatëve kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën se si u është mundësuar paraqitja e dëshmimeve. 14% e qytetarëve kanë qenë relativisht të pakënaqur, dhe 23% e qytetarëve dhe 38% e avokatëve nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.
- 53% e qytetarëve të anketuar dhe gjysma e avokatëve kanë qenë relativisht të kënaqur me mënyrën se si gjykatësi i ka dëgjuar dëshmitarët. 16% e qytetarëve kanë qenë relativisht të pakënaqur, dhe 18% e qytetarëve dhe 50% e avokatëve nuk kanë qenë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.
- 45% e qytetarëve të anketuar që kanë marrë pjesë në procedurë gjyqësore civile nuk janë të kënaqur me kohëzgjatjen e saj. Shumica e avokatëve të anketuar (44%) kanë vlerësuar me 3 kënaqëshmërinë e tyre nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shkallë nga 1 në 5.
- Gjykata e Lartë dhe gjykatat e apelit nuk kanë publikuar të dhëna në faqet e internetit për shpenzimet e nevojshme për udhëheqjen e procedurave. Pesë gjykata themelore nuk kanë publikuar asnjë informatë në lidhje me shpenzimet për vërtetime, certifikata ose vërtetimeve të ndryshme. 15 gjykata themelore nuk kanë publikuar asnjë informatë mbi shpenzimet për procedura tjera. Është e nevojshme që të gjitha gjykatat t'i publikojnë shpenzimet e procedurave.

